

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7801 E shtunë 23 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **Ditës**

**U**bënë 48 orë që 675 mijë qytetarë të vendit (votues të dy partive kryesore opozitare në zgjedhjet e qershorit 2017) janë pa përfaqësim në jetën tonë politike. Kjo nuk ka...

Vijon në faqen 20

**Nga FATOS ÇOÇOLI**

**Kontrata e prishur dhe gjumi i prishur**



**Opinion** **Ditës**

**Q**ë nga protesta e opozitës të shtunën, kur u thyen 2-3 tre xhama dhe kur shkërmoq kërpudha e artistit bashkëkohor Carsten Holler, i gjithë debati i politikës...

Vijon në faqen 21

**Nga ANDI BUSHATI**

**Edhe njëherë për domosdoshmërinë e "dhunës"**



Lista e dytë/ Dosjet janar-tetor 2018

## Të përndjekurit, 5 mijë emrat që marrin paratë e dëmshpërblimit

Të dhënat e detajuara për trashëgimtarët, ja cilat dokumente duhet të dorëzojë secili

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Financave. Janë në total 5 mijë përfitues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Pagesave nga janari deri në tetor të vitit të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur...

Në faqen 10-11

## OPOZITA/ KRYEMADHI: QEVERIA DO TE INTENSIFIKOJE DHUNEN DHE PRESIONIN

# BASHA Mbledh kryesinë e PD: PROTESTA NE TIRANE E RRETHE

Përrjashtohet Myslim Murrizi, deputeti që nuk dorëzoi mandatin. Reagimi: U nisën për të hequr Ramën dhe më hoqën mua. Kriza, PE sjell delegacion në Tiranë



(Në foto) Kryemadhi, Basha dhe Berisha gjatë protestës së opozitës

Në faqen 3

### "ATA HUMBIN ZGJEDHJET"



**Rama: Të kujdesemi për demokratët, janë të tradhtuar nga Lulzim Basha**

Në faqen 5

### BLUE TOOTH

Nga Rina te Stresi, historia e reperëve me probleme me ligjin

## Në skenë apo në qeli? VIP-at e dënuar së fundi

E lidhur me DJ Sardin? Nevina Shtylla: Mirë që s'më lidhni me femër

Nga PAMELA ALIAJ

Jetesa në Shqipëri nuk është aspak e lehtë dhe shumë prej nesh zgjedhin një rrugë jo të lehtë dhe të jashtëligjshme për më tepër për t'ia dalë në një jetë më të mirë. Këtë rrugë e zgjedhin jo vetëm njerëzit e thjeshtë, por



edhe VIP-at tanë. Jo të gjithë e kanë të lehtë të mbijetojnë në varfëri, por disa prej tyre u pëlqen rreziku dhe preferojnë ta jetojnë adrenalinën në maksimum. Kush merret me narkotikë e kush parapëlqen të marrë gjobë për shpejtësi, e kush thjesht të zihet...

Suplement

**DREJTESIA**

**Ministria e Jashtme gjermane: Akuzat për korrupsion duhet të trajtohen**

Në faqen 2

**LISTA E PASUESVE**

**Opozita dorëzoi mandatat, kush janë 56 kandidatët për të hyrë në Kuvend**

Në faqen 4

**FINANCAT**

**Borxhet, Denaj: Do shlyejmë 19 miliardë lekë te bizneset brenda vitit 2019**

Në faqen 6

**SHKODER**

**Video intime, gjykata liron inspektorin e policisë: Nuk ka denoncim**

Në faqen 9

# SITUATA POLITIKE REAGIMET

Djedia e mandateve, CDU/CSU: Duhet dialog, integrimi në BE në rrezik

Valentina Madani

Një delegacion i Komisionit të Punëve të Jashtme të Parlamentit Europian do të mbërrijë pasditen e 27 shkurtit në Tiranë për t'u informuar në detaje mbi situatën e re në të cilën është futur vendi, pas dorëzimit të mandateve parlamentare të opozitës dhe hapat që priten të merren në vazhdimësi. Ky delegacion përbëhet nga deputetë të grupeve të ndryshme politike të Parlamentit Europian. Grupimi i Partive Popullore (EPP) përfaqësohet nga Cristian Dan Preda dhe Tunne Kellan. Grupimi i socialistëve dhe demokratëve (S&D) përfaqësohet nga raportuesi për Shqipërinë, Knut Fleckenstein dhe Juan Fernando Lopez Aguilar. Grupimi i liberalëve dhe demokratëve (ALDE) përfaqësohet nga Ilhan Kyuchuk. Grupimi i gjelbër (The Greens) nga Tamas Mezserics. Grupimi i konservatorëve dhe reformistëve (ECR) do të përfaqësohet nga Bas Belder dhe grupimi i Europës së Kombeve dhe Lirive (ENF) Jean-Luc Schaffhauser. Në fillim mësohet se delegacioni i Parlamentit Europian do të takohet me kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha dhe kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi. Më pas, takimet vijojnë me kryeministrin Edi Rama dhe ministrin e Punëve të Jashtme në detyrë, Gent Cakaj. Delegacioni do të takohet edhe me kreun e Kuvendit, Ruçi, si dhe dy përfaqësues të shoqërisë civile, ndërka nuk përjashtohen takimet me ministrin e Brendshëm dhe ministrin e Drejtësisë. Delegacioni i PE do të ketë një deklaratë të përbashkët për mediat në përfundim të vizitës zyrtare në Tiranë.

## REAGIMI

Pas dorëzimit në bllok të mandateve të deputetëve të opozitës, reagoi edhe partia e Angela Merkel në Gjermani. Përmes zëdhënësit të saj Florian Hahn, CDU/CSU vlerëson se Shqipëria po humbet shumë kredite në sytë e miqve europianë. Sipas Hahn, vendi bën që Shqipëria të humbasë kreditet tek partnerët evropianë. "Shqipëria është në proces të humbjes së shumë kredive për miqtë evropianë. Ndërsa perspektivat për negociatat e pranimit në BE ishin ende rozë në mes të vitit të kaluar, tani janë mbledhur retë e errëta. Protestat në vazhdim në Tiranë paralajzojnë qeverinë dhe paralizojnë veprimtarinë parlamentare. Protestat dhe demonstrimet janë të drejta civile dhe një tzipar i demokracisë kur trajtohen në mënyrë adekuatë. Por, deputetët e partive tona partnere në Shqipëri i bëjnë një shërbim të keq (autogol) qëllimit të tyre,

# Kriza, PE delegacion prej 8 vetash të mërkurën në Tiranë

BE: Lënia e mandateve minon procesin e integritimit



Parlament Europian

## TAKIMET

Në fillim mësohet se delegacioni i Parlamentit Europian do të takohet me kryetarin e PD-së, Lulzim Basha dhe kryetaren e LSI-së, Kryemadhi. Më pas takimet vijojnë me kryeministrin Rama, ministrin e Punëve të Jashtme në detyrë, Gent Cakaj dhe kreun e Kuvendit.



Protesta e opozitës para kryeministrisë

## Berisha, apel ndërkombëtarëve: Shihni realitetin, vendi drejt një konflikti civil

Ish-kryeministri Berisha reagoi dhe ndaj kritikave të ndërkombëtarëve për vendimin ekstrem të djegies së mandateve nga opozita, por u kërkoi partnerëve të njihen sipas tij me realitetin e keqeverisjes në Shqipëri dhe kapjes së institucioneve nga mazhoranca. "Ky është një veprim që ka një qëllim të vetëm: mospranimin për të qenë fasadë për të keqen, por të dilet në shesh për të mbrojtur ato vlera të shoqërisë të lira. U bëj thirrje të vijmë miqtë tanë, të shohin realitetin në Tiranë dhe në Shqipëri dhe i siguroj se do të gjejnë një realitet më të ndryshëm seç kanë në tavolinë. Protesta në Shqipëri, dorëzimi i mandateve është dëfta e jashtëzakonshme, por në mënyrë absolute është i diktuar nga rrethana të jashtëzakonshme", theksoi z.Berisha. Pas vizitës që bëri në ekspozitën e piktorit Avni Delvina, e frymëzuar nga Presidenti amerikan Donald



Trump, Berisha tha se po shkohet drejt konfrontimit civil dhe u bëri thirrje socialistëve që të largojnë sa më parë kryeministrin Rama, duke e cilësuar atë rrezik kombëtar. "U bëj thirrje socialistëve në interesin më të mirë të tyre që të largojnë me urgjencë Edi Ramën dhe klikën e tij nga pushteti, sepse e them me bindjen time më të thellë se urrejtja ndaj tij bëhet çdo ditë me e pakufishme. U bëj thirrje socialistëve të mos nënlerësojnë situatën, sepse në mënyrë absolute ndëshkimi popullor për Edi Ramën do të jetë tepër

## AKUZA

Ish-kryeministri Sali Berisha përmes një postimi në "Facebook" shkruan se Edi Rama ka shpërndarë në ambasada dhe qeveri të ndryshme një video si provë se ndaj tij po i bëhet grusht shteti. Videoja e titruar në anglisht është 1 minutë e gjatë.

i sigurt. Ndaj, t'i thërrasin mendjes. Situata në rrafshin social dhe politik është eksplozive. Po shkohet drejt konfrontimit civil, jemi në kushtet e grushtit të shtetit. Çdo javë e Edi Ramës në pushtet është rrezik madhor kombëtar. Ik! Ik dhe vetëm ik! Dilni socialistë, përzini Edi Ramën, largoni nga pushteti njeriun më të rrezikshëm pas Enver Hoxhës. Vllimi te qytetarët është i jashtëzakonshme. Është mirë që Rama të ikë përpara se do të largohet në një mënyrë që s'e mendon dot", theksoi z.Berisha.

nëse nëpërmjet dorëzimit masiv të mandateve do të shkaktojnë një stanjacion politik dhe do të nxisin protesta të dhunshme. Një qëndrim refuzues nuk i shërben as vendit, as qytetarëve", theksoi z.Hahn. Më pas, ai u bëri thirrje miqve në Shqipëri për ma-

turi. "Qeveria dhe opozita duhet të fillojnë menjëherë diskutimet, në mënyrë që të vazhdojë përsëri veprimtaria parlamentare. Perspektiva evropiane është në rrezik", shtoi zëdhënësi i CDU.

## MANDATET

Ambasadori i Bashkimit

Evropian në Tiranë, Luigi Soreca, shprehu dje shqetësimin se heqja dorë nga mandatet e deputetëve të opozitës minon procesin e integritimit të Shqipërisë. "Në këtë moment është shumë herët të bëj ndonjë parashikim. Pasiguria në vend është shumë e lartë.

## PD, me delegacionin çek: Djegia mandateve, ruga e vetme për opozitën

Zyrtarët e lartë të PD-së zhvilluan dje një takim pune me delegacionin e Parlamentit të Republikës Çeke, kryesuar nga kryetari i Komisionit për Punët e Jashtme, Ondřej Benešik. Sekretari i Përgjithshëm i PD, Gazmend Bardhi; kreu i FRPD, Belind Këlliçi dhe nënkryetari i FRPD, Lisandër Hoxha informuan delegacionin çek mbi situatën politike në Shqipëri dhe sqaruan parlamentarët e vendit anëtar të BE-së se, "djegia e mandateve ishte e vetmja rrugë që i kishte mbetur opozitës, përballë qeverisë së ardhur në pushtet me votat e blerë nga krimi i organizuar dhe mundësia e vetme për të mbrojtur demokracinë e vlerave evropiane". Zyrtarët e PD-së informuan delegacionin çek për raset e identifikuar dhe të provuara nga hetime zyrtare për blerjen e votave që sipas PD janë realizuar nga elementë të kimit të organizuar për llogari të PS-së.

Ne kemi hyrë në këtë situatë vetëm dje. Ka kaluar shumë pak kohë. Ajo që mund të them është se pa dialog nuk ka zgjidhje në rrugën e Shqipërisë për në Bashkimin Evropian, në të cilën ajo ka bërë një progres shumë të madh. Heqja dorë nga mandatet minon procesin integruar të Shqipërisë drejt BE-së. Deputetët kanë përgjegjësi ndaj votuesve, presim që qeveria dhe opozita të angazhohen në dialog", deklaroi ambasadori i BE-së në Tiranë.

## ZGJEDHJET

Ministria e Jashtme gjermane thekson në një deklaratë tjetër dje për "Deutsche Welle", se akuzat për zgjedhjet duhet të trajtohen nga drejtësia dhe parlamenti. Pas deklaratës së Berlinit zyrtar

për djegien e mandateve nga deputetët e opozitës shqiptare, "Deutsche Welle" e pyeti Ministrinë gjermane të Punëve të Jashtme edhe për protestat e opozitës. Përgjigja e Ministrisë së Punëve të Jashtme është si më poshtë: "Akuzat që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e zgjedhjeve të mëparshme duhet të trajtohen dhe të gjykojnë nga organet e drejtësisë dhe parlamenti. E drejta për të demonstruar është një element i rëndësishëm i kushtetutës demokratike. Megjithatë, dhuna, siç e pamë të shtunën e kaluar, është e papranueshme. Ne u bëjmë thirrje të gjitha palëve të përfshira që të ndihmojnë që protestat e mëtejshme të jenë paqësore".





Nuk dorëzoi mandatin, kryesia përjashtoi Murrizin: Shkeli vendimin e grupit

# PD, kalendar protestash, Basha: Zgjedhjet janë mbrapa derës

Zbardhen porositë, ngrihen shtabet e punës

Valentina Madani

Një ditë pas dorëzimit të mandateve të deputetit e protestës së opozitës së bashkuar kundër qeverisë "Rama", lideri i opozitës, Lulzim Basha, zhvilloi dje një takim me përfaqësues të Partisë Popullore Europiane në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së. Takimi u njoftua nga vetë PPE, përmes një postimi në "Twitter", ku edhe u shpërndanë foto të bisedës me kryedemokratën Basha. "Kishim një ftuar special, Lulzim Bashën, i cili na raportoi për situatën shqetësuese në Shqipëri, protestat kundër qeverisë socialiste, korrupsionin, trafikimin e drogës dhe zhvillimet jodemokratike", - thuhet në postimin e PPE-ve.

**VENDIMET**

Pas kthimit nga Vjena, kryetari i opozitës, Lulzim Basha mbledhi dje kryesinë e PD-së nga ku urdhëroi strukturat e partisë që të mobilizohen, pasi sipas tij zgjedhjet janë mbrapa derës. Gjatë mbledhjes me djer të mbyllura mësohet se kreu i demokratëve ka ngritur një grup punë, që do të ketë në fokus paraqitjen e alternativës së PD-së. Sipas tij, PD-ja nuk ka më pse të harxhojë kohë, por ajo duhet të përgatitet për zgjedhjet. "Të bëhet ndërthurja e protestës me shpalosjen e alternativës. Grupi i punës që do të ngrihet për arsimin e lartë, do të jetë për çdo fushë kryesore, për pensionet, për shëndetësinë, për investimet etj.. Të nisim punën, sepse mund të jemi me zgjedhjet mbrapa derë. Nuk kemi pse të harxhojmë asnjë minutë", - tha z.Basha. Kurse për mediat pas mbledhjes së kryesisë, Basha njoftoi se bashkë me qytetarët shqiptarë, ai do të punojë që ta bëjë Shqipërinë një vend më të mirë. Ai e bëri të qartë se vendimi i parë i kryesisë së PD ishin protestat në të gjithë vendin. "Vendimi i parë i kryesisë ka të bëjë me hartimin e një kalendarit protestash popullore të shtrira në të gjithë vendin dhe natyrisht, protestave kombëtare në Tiranë, për të cilat në ditët në vijim Kolegji i Kryetarëve dhe Këshilli Kombëtar i PD-së do të marrin vendimet përkatëse të organizimit të kal-



Lideri i opozitës, Lulzim Basha, gjatë mbledhjes së Kryesisë së PD-së

**MYSLIM MURRIZI**

PD-ja e përjashtoi atë nga të gjitha funksionet në parti, por menjëherë pas këtij vendimi, reagoi Murrizi. "U nisën për të rrëzuar Ramën, por më rrëzuan mua. Unë nuk pres tjetër vendim nga katër ish-bij sekretarësh komunistë", u shpreh Murrizi.

**VIZITA**

Një ditë pas dorëzimit të mandatit të deputetit e protestës së opozitës së bashkuar kundër qeverisë "Rama", kryedemokrati Basha zhvilloi një takim me përfaqësues të Partisë Popullore Europiane në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së. Takimi u njoftua nga vetë PPE në "Twitter" ku edhe u shpërndanë foto të bisedës me Bashën.



**DORËHEQJET**

Në selinë e PD-së ka nisur marrja e deklaramëve të kandidatëve pasues në listat e PD-së, të cilët nuk do ta pranojnë mandatin e deputetit që lanë kolegët e tyre. Edhe pse ka një vendim politik të Këshillit Kombëtar, procesi po ecën me ngadalë se dorëheqjet kolektive të deputetëve".



**Kryetarja e LSI: Protesta lineare në çdo qytet**

**Kryemadhi: Qeveria do të intensifikojë presionin, dhunën dhe intimidimin**

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, dje në mbledhjen e Komitetit Drejtues Kombëtar lajmëroi se kryetarët e partive në qarqe duhet të përgatiten për atë që ajo e quajti si "protestë lineare". Kryemadhi tha para drejtuesve të LSI-së se protesta e qytetarëve tregoi se ata e mbështesin opozitën, ndaj dhe protestat do të vijojnë në çdo cep të Shqipërisë. "Kryetarët e partive do të vijojnë protestën lineare në çdo qytet dhe në çdo cep të Shqipërisë. Protesta e djeshme tregoi se shqiptarët përkrahin opozitën", tha Kryemadhi. Ajo përgatiti anëtarët e saj për një sulm qeveritar ndaj tyre. Por, Kryemadhi tha se i kanë parashikuar të gjitha, pasi vendosën të lënë mandatin dhe se nuk do të ndalojnë në aksionin e tyre. "Ne jemi të përgatitur për çdo lloj skenari të mundshëm që kërkon të organizojë grupi kriminal, që sot ka emrin Rilindje. Të jeni të bindur se presioni, dhuna dhe intimidimi ndaj njerëzve të LSI-së do të jetë pafundësisht. Dikujt do t'i trokasë policia në derë, dikujt do t'i hiqet gruaja nga puna, qoftë edhe sanitare në një shkollë fshati; dikujt do t'i vijë ndonjë letër prokurorie që e thërrret, dikujt do t'i vijë zarfi me para në shtëpi për të shlyer borxhet apo për të paguar shkollën e fëmijës, apo diçka tjetër; dikujt do t'i vendosin lëndë eksplozive në dyert e shtëpive apo bizneseve. Vendimi i opozitës është vetëm një: ta kthejmë Shqipërinë në shtëpinë tonë", theksoi zj.Kryemadhi.

**"Protestat vazhdojnë, tur takimesh në rrethe"**

**Tabaku: Kuvendi të shpërndahet, s'ka marrëveshje për ndarje pushteti**

Ish-deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, lajmëroi dje se protestat e opozitës do të vazhdojnë, ndërsa shton se parlamenti duhet të ishte shpërndarë, pasi mbeti vetëm me gjysmën e tij. "Ne do të jemi me qytetarët. Do të nisë një tur në të gjitha qytetet. Do të ketë një plan pune. Do të jetë i ngjashëm me turin e para protestave, që e ngriti fort këtë frymë. Pamë qytete të tëra që kishin nevojë për vendime dhe që janë shënuar me zero nga qeveria. Rezultatit kryesor ne e



presim me heqjen dorë të mandateve, me të cilën PD ka treguar se parlamenti nuk ekziston më dhe demokracia ka rënë. Pa gjysmën, parla-

menti duhet të ishte shpërndarë", tha Tabaku për "Ora News". Sipas saj, ky akt që ne kemi ndërmarrë nuk është një thirrje për t'u ulur në tavolinë me Edi Ramën. "Nuk ka këtu marrëveshje për ndarje pushteti, ndarje drejtorish dhe ministrish. Këtu bëhet fjalë për të kthyer përmbyës këtë sistem. Që është ngritur në 6 vite dhe për të krijuar diçka të re për të ardhmen evropiane. Kërkohej një qeveri transicioni për të na çuar në zgjedhje të lira dhe të ndershme", theksoi zj.Tabaku.

endarit të datave të mobilizimit mbarëqytetar për të vazhduar protestat mbarëpopullore për largimin e Maduros së Ballkanit. Është marrë një vendim për ngritjen e shtabëve në nivel qendrorë dhe lokal, të cilët në bashkëpunim me opozitën e bashkuar do të bëjnë të mundur organizimin e protestave në të gjithë vendin", deklaroi z.Basha.

**PËRJASHTIMI**

Kryesia e PD-së mori dje masa ndaj deputetit të Lushnjes, Myslim Murrizi, për vendimin e tij për të mos djegur mandatin e deputetit.

Mësohet se Murrizi u shkarkua nga funksionet dhe anëtarësia për shkeljen e vendimit të grupit parlamentar, kryesisë dhe Këshillit Kombëtar. PD-ja e përjashtoi atë nga të gjitha funksionet në parti, por menjëherë pas këtij vendimi, reagoi me ironi Murrizi. "U nisën për të rrëzuar Ramën, por më rrëzuan mua", u shpreh Murrizi. Sipas tij, ky është një vendim që e priste dhe nuk ishte i pari që ndërmerrej ndaj tij. Ai shtoi se nuk pret tjetër qasje, kur ky vendim merret nga katër drejtues, të cilët janë ish-bij komu-

nistësh. "Nuk është hera e parë që merret një vendim i tillë ndaj meje. Kjo është frymë e partisë të lidhur me Sigurimin, që sillen në këtë formë kur nuk u vjen pas avazit. Unë nuk pres tjetër vendim nga katër ish-bij sekretarësh komunistë", tha Murrizi për "Opinion.al". I pyetur nëse do të jetë në parlament në vazhdim dhe nën çfarë sigle, Murrizi tha se: "Unë do jem aty si përfaqësues i elektoratit tim dhe i studentëve të dhjetorit, që u ngritën dhe thanë e duam Shqipërinë si Evropa dhe Amerika".

# KRIZA POLITIKE MANDATET

## Kuvendi kalon në mënyrë të përshpejtuar mandatet e opozitës në KQZ

Mazhoranca nuk ka llogaritur që në një ditë dhe ka vendosur të vepronte me procedurë të përshpejtuar për zëvendësimin e deputetëve të opozitës, të cilët kanë dorëzuar mandatet. Kuvendi i Shqipërisë vetëm një ditë pasi kërkesat për dorëzimin e mandateve u depozituan në protokoll, ia ka përcjellë ato Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në mënyrë që ky i fundit të vijojë me procedurën e zëvendësimit siç e parashikon edhe ligji zgjedhor. Në total mësohet se janë 56 kërkesa për lënien e mandatit nga deputetët e Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, të cilët u bindën vendim-marrjes politike për dëgjimin e mandateve. Dosja e Kuvendit mësohet se ka mbërritur gjatë pasdites së



sotme në KQZ dhe pritet që edhe KQZ të vepronte me shpejtësi për zëvendësimin e vakancave të krijuara nga kjo vendim-marrje e opozitës. Kështu, mësohet se gjatë ditës së djeshme anëtarët e

propozuar nga PS si anëtarë të KQZ-së kanë zhvilluar një mbledhje në Kryeministri, ku dhe kanë marrë direktivat se si duhet të vepronin në vijim për këtë çështje. Një nga porosistë e marra, siç mësohet, është edhe procedimi sa më parë i miratimit të këtyre dorëheqjeve dhe zëvendësimit me kandidatët vijues. Kodi përcakton se KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën e kandidatëve të regjistruar nga një subjekt zgjedhor. Vendimi i njoftohet kandidatit dhe botohet në Fletoren Zyrtare. Nëse kandidati i radhës nuk paraqitet në Kuvend brenda 30 ditëve

nga njoftimi, pa shkaqe të përligjura, mandati i kalon kandidatit vijues të listës. Por, KQZ e ka bërë praktikë që të pranojë edhe deklaratat paraprake të kandidatëve për të mos e marrë mandatit, ndaj në këtë rast nuk është e thënë që ajo të presë afatin 30-ditor për të vijuar me procedurën e zëvendësimit. E njëjta procedurë vazhdon deri në shterimin e listës së kandidatëve të së njëjtës parti politike. Në rast kur është shteruar lista e kandidatëve të partisë politike, anëtarë e një koalicioni, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë.



KQZ-ja javën e ardhshme do të marrë vendim për plotësimin e vakancave të opozitës

# Dorëzimi i mandateve, ja 56 kandidatët që mund të hyjnë në Kuvend

Lista, nga Maliaqi, Karamelo te Tahiri e Zogaj

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pritet që javën e ardhshme të mbledhet për të bërë plotësimin e vakancave të krijuara nga dorëzimi i mandateve të deputetëve të opozitës. Kjo, pasi shumica qeverisëse kërkon që t'i japë zgjidhje sa më parë krizës politike që ka shkaktuar vendimi i partisë opozitare dhe t'u japë mundësinë personave apo forcave të tjera politike që të mund të marrin mandatet e lëna nga deputetët aktualë. Kodi Zgjedhor në nenin 164 përcakton se mandati i ndërprerë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. I njëjti nen sanksionon edhe detyrimin që në rast se një nga subjektet zgjedhore nuk ka respektuar ligjin e barazisë gjinore në momentin e dorëzimit të listave të kandidatëve, atëherë mandati i dorëzuar i jepet një kandidatë femër. Kështu, referuar këtij detyrimi ligjor rezultojnë se një pjesë e mirë e kandidatëve të cilëve do t'u ofrohet mandati nga KQZ-ja janë femra. Kjo, pasi Partia Demokratike nuk e ka respektuar detyrimin e barazisë gjinore në shumicën dërmuese të listave shumëmemërore.

### KANDIDATËT

Referuar faktit se deri më tani janë dorëzuar 56 mandate deputetësh, atëherë KQZ-ja do duhet që t'ua ofrojë ato 56 kandidatëve që gjenden në listat e PD-së dhe LSI-së. Më konkretisht, në Qarkun e Beratit janë 4 kandidatë, 2 nga PD dhe 2 nga LSI. Bie në sy mes tyre edhe emri i Lefter Maliaqit, i cili në

zgjedhjet e 2017 kandidoi nën siglën e PD-së, ndonëse më pas punoi për PS dhe sot mban një pozicion të rëndësishëm në administratën shtetërore. Në Dibër KQZ-ja do t'ua ofrojë mandatet 3 kandidatëve të opozitës, ndërmyjet

të cilëve edhe dy kandidatë femra. Në qarkun e Durrësit janë 5 kandidatë që presin kësaj here t'u ofrohet mandati nga KQZ dhe mes të cilëve bie në sy emri i Agron Dukës dhe ai i Vullnet Topallit. Kujtojmë se në këtë qark

Lefter Koka i LSI-së nuk pranoi ta dorëzonte mandatet e deputetit. Në Elbasan janë 6 kandidatë të opozitës që janë në radhë për të marrë mandatet e deputetit, mes të cilëve edhe dy kandidatë femra. Pjesë e kësaj liste është

### LISTA E KANDIDATËVE QË KANË RADHËN PËR TË MARRË MANDATIN E DEPUTITIT

■ **Qarku Berat**  
Lefter Maliaqi - PD  
Bujar Hoxhaj - PD  
Llambriola Misto - LSI  
Taulant Vrapit - LSI

■ **Qarku Dibër**  
Denisa Vata - PD  
Edmond Isaku - PD  
Aurora Mara - LSI

■ **Qarku Durrës**  
Dejana Burgja - PD  
Helenida Sava - PD  
Agron Duka - PD  
Vullnet Topallaj - PD  
Edlira Hyseni - LSI

■ **Qarku Elbasan**  
Nada Tapija - PD  
Taulant Zeneli - PD  
Arben Elezi - PD  
Fitimitar Zekthi - PD  
Rudina Mita LSI  
Enver Rroshi LSI

■ **Qarku Fier**  
Luljeta Sejko - PD

Olsi Çukaj - PD  
Dilaver Kamberaj - PD  
Erisa Xhixho - LSI

■ **Qarku Korçë**  
Qarku Gjirokastër  
Mimoza Çomo - PD  
Edlira Braha - LSI

■ **Qarku Kukës**  
Soela Myrtalari - PD  
Andrea Mano - PD  
Ligoraq Karamelo - PD  
Fatmir Guda - PD  
Piro Kapurani - LSI

■ **Qarku Kukes**  
Alban Zeneli - PD  
Miftar Dauti - PD

■ **Qarku Lezhë**  
Enkeleja Rica - PD  
Preç Zogaj - PD  
Martin Biba - PD  
Elda Hoti - LSI

■ **Qarku Shkodër**  
Benardeta Syku - PD

Gjokë Ulledaj - PD  
Anton Koka - PD  
Prele Gjoni - PD  
Dritan Ylli - LSI

■ **Qarku Tiranë**  
Gerti Bogdani - PD  
Mirela Dragoni - PD  
Barbara Doda - PD  
Enkeleja Sallaku - PD  
Besmira Petriti - PD  
Fuad Haxhiymiri - PD  
Blendi Sulaj - PD  
Flamur Hoxha - PD  
Fatbardh Plaku - PD  
Dorjan Teliti - PD  
Besnik Fuçja - PD  
Erion Bixha - LSI  
Klivi Pojana - LSI  
Ardit Çela - LSI  
Ylli Shehu - LSI  
Edmond Rushi - LSI

■ **Qarku Vlorë**  
Matilda Qurku - PD  
Arben Ristani - PD  
Dashamir Tahiri - PD  
Sokol Dervishaj - LSI

### EMRAT

Ndër emrat e PD-së bie në sy emri Gerti Bogdani, Fatbardh Plakut dhe Dorjan Teliti, ndërkohë që nga LSI-ja, ai i ish-deputetit Ylli Shehut. Në qarkun e Vlorës mundësia për të marrë mandatit i jepet Dashamir Tahirit nga PD-ja dhe Sokol Dervishajt nga LSI-ja.

edhe gazetari Fitimitar Zekthi. Në Fier janë 4 kandidatë në listë që kanë radhën për të marrë mandatit, mes të cilëve dy kandidatë femra, përfshi edhe Erisa Xhixhon. Në këtë qark kujtojmë se Myslim Murrizi nuk pranoi të dorëzoi mandatit e deputetit. Në Qarkun Gjirokastër janë në radhë dy kandidatë dhe mandatit që ka lënë Tritan Shehu e merr Mimoza Çomo. Në Korçë janë 5 kandidatë në listë për të marrë mandatet e lëna, ku bie në sy edhe emri i Ligoraq Karamelos dhe ish-deputeti i LSI, Piro Kapuran-

it. Ndërkohë që në Kukës zgjedhja është e detyruar, pasi në listën e PD kanë mbetur vetëm 2 kandidatë dhe ata janë Alban Zeneli dhe Miftar Dauti. Në rast se edhe këta nuk e pranojnë mandatit, atëherë në këtë qark KQZ në një raund tjetër dhëniesh mandateve do duhet t'ua ofrojë mandatet e PD-së, kandidatëve të LSI-së. Në qarkun Lezhë në listën e kandidatëve që do u ofrohet mandati janë 4 emra, ndërmyjet të cilëve dy femra. Në qark në listë është edhe ish-deputeti dhe publicisti, Preç Zogaj. Ndërkohë që në listën e Shkodrës bie në sy emri i ish-deputetit Gjokë Ulledaj dhe ai Dritan Yllit.

### TIRANA

Në qarkun e Tiranës, radha kandidatëve që janë në listë për të marrë mandatet e deputetëve është më e madhe. Nga PD janë 11 kandidatë dhe nga LSI 5. Ndër emrat e PD-së bie në sy emri Gerti Bogdani, Fatbardh Plakut dhe Dorjan Teliti, ndërkohë që nga LSI ai i ish-deputetit Ylli Shehut. Në qarkun e Vlorës mundësia për të marrë mandatit i jepet Arben Ristani dhe Dashamir Tahirit nga PD dhe Sokol Dervishajt nga LSI.





**K**ryeministri Edi Rama e konsideron tashmë një fakt të kryer dorëzimin e mandateve të opozitës, ndërsa vlerëson nevojën për të përfaqësuar tashmë edhe demokratët, të cilët sipas tij kanë mbetur të tradhtuar nga Partia Demokratike. Ai ishte dje në Gjirokastër në vijim të turit të tij "Bashkia që duam", ku nuk iu shmang as debatit për situatën aktuale politike dhe veprimin ekstrem dhe të paprecedent të opozitës për të lënë mandatet e deputetëve. Ai theksoi se demokratët kanë mbetur jetim, ndërkohë që theksoi se qëllimi i këtij veprimi nga ana e opozitës ka të bëjë me dëmtimin e imazhit të Shqipërisë në sytë e të huajve dhe të shkatërronjë ato që sipas tij, janë arritur në gjithë këto vite. "Demokratët kanë mbetur jetimë, të tradhtuar, të tallur. Jetimë të cilët kërkojnë t'i marrin për budallenj, t'i tërheqin prej hunde, për çfarë? Për t'i vënë flakën atyre që janë ndërtuar për të djegur edhe njëherë imazhin e Shqipërisë në sytë e botës. Këta duan të përdorin si mish për top ata që i tradhtuan, atyre që iu morën votat për të luftuar për një vizion që se kanë pasur kurrë", - tha kryeministri Edi Rama. Ndërkohë që arsyet e këtij veprimi të opozitës, ai i lidhi me pamundësinë e PD-së dhe kryetarit të saj, Lulzim Basha për të fituar zgjedhjet e votë dhe për të bllokuar reformën në drejtësi. "Duhet të kujdesemi për të gjithë miqtë tanë demokratë, të cilët u tradhtuan nga deputetët e tyre. U them demokratëve se kjo nuk ka lidhje me ato që thuhet, por me ato që dihen. E dinë që nuk kanë asnjë shans të na mundin. Lulzimi nuk e përballon dot edhe një humbje tjetër. Edhe ata që e kanë vënë aty nuk e mbajnë dot më. Ai dhe partia e tij po dalin të humbur shumë më shumë se sa do dilnin nga zgjedhjet. Ata janë në panik, pasi nuk kanë më asnjë mundësi të pengojnë reformën në drejtësi. Drejtësia e re ka disa punë me ta", - shtoi Rama. Më tej, ai duke pranuar se djegia e mandateve nuk ishte një gjë e mirë jo vetëm për opozitën, por edhe për gjithë vendin, kryeministri theksoi se gjithsesi, as ky akt nuk do ta pengojë dot vendin dhe qeverinë për të qeverisur me mirë. "Nuk është mirë që ata u larguan por nga ana tjetër,

Kreu i qeverisë theksoi se djegia e mandateve u bë pasi PD nuk fiton dot zgjedhjet

# Rama: Të kujdesemi për demokratët, janë të tradhtuar nga Basha

"Lulzimi nuk e përballon dot edhe një humbje tjetër"



Kryeministri Edi Rama, dje në Gjirokastër

**PROTESTA**

Kryeministri Edi Rama është pritur me protesta edhe dje në Gjirokastër. Ashtu si edhe në Lezhë para pak ditësh, disa simpatizantë demokratë kanë dalë në rrugë, me qëllim pengimin e kalimit të kreut të qeverisë. Me thirrjet "Rama ik" ata kanë bllokuar rrugën, ndërsa është dashur angazhimi i forcave të policisë për lirimin e saj.

**BASHKIA**

"E kemi fituar Bashkinë e Gjirokastrës në koalicion, por shumë gjëra që nuk janë bërë me ne do të ecnin shumë më shpejt dhe do të bëhen shumë më mirë sapo të vijmë zgjedhjet e ardhshme. Ne e dimë shumë mirë se Shqipëria që kemi nuk është ajo që duam, por është si dita me natën me atë që kishim, kështu do jetë edhe Gjirokastra".

**Pjerin Ndreu: Kandidoj për Bashkinë e Lezhës, por është e lehtë**

**N**uk ka surpriza për kandidaturën që do përfaqësojë Partinë Socialiste për Bashkinë e Lezhës. Pjerin Ndreu do të lerë mandatin e deputetit për të kandiduar për kryetar të Bashkisë së Lezhës. Këtë e ka konfirmuar dje vetë Ndreu gjatë një interviste për "Report TV", ku theksoi se gara për këtë bashki nuk do jetë e lehtë. "Do të kandidoj, por nuk jam delirant që të mendoj se e kam në çante, por atë bashki duhet ta marrë unë dhe të bëjë një revolucion. Ajo është kthyer në godinë punësi dhe jo shërbimi. Punojnë 1200 vetë. Kam mbështetjen e plotë të PS-së, po sot do takoj të gjithë anëtarët e PS-së në të gjitha njësitë. Do u tregoj se çfarë ka ndodhur këto vite dhe si është keqmenaxhuar ajo bashki", - tha Pjerin Ndreu. Pak ditë më parë edhe Rama la të kuptohet se Ndreu do ishte kandidati i PS për këtë bashki, megjithëse theksoi se këtë do e vendosin strukturat.

## Bojaxhi: "Sfida" duhet t'i marrë mandatet për të luftuar PD dhe PS



qytetarët shqiptarë, për të denoncuar më shumë korrupsionin, nepotizmin dhe çdo gjë që shkon keq në këtë

**N**ë rast se PD dhe LSI do të çojnë deri në fund vendimin e tyre dhe kandidatët që gjenden në listat shumëmërore të këtyre dy partive nuk do të pranojnë të marrin mandatet e lëna nga deputetët aktualë, atëherë forca të tjera politike mund të bëjnë opozitën në parlament. Një prej tyre është edhe partia "Sfida", që në zgjedhjet e shkuara parlamentare drejtohej nga Gëzim Bojaxhi. Ai ka lënë të kumbotet dje se nuk do ta humbte rastin për të bërë opozitë ndaj të gjitha partive kryesore, që sipas tij janë përgjegjëse për këtë situatë në të cilën ndodhet sot vendi. "Çdo podium që ne mund ta përdorim për t'u dëgjuar më shumë nga

vend, unë mendoj - nuk dua të flas në emër të 'Sfidës', sepse nuk jam kryetar i saj, - që një parti si Sfida duhet ta përqafojë këtë mundësi për të denoncuar dhe diskredituar gjithçka shkon keq. Pavarësisht se, në qoftë se ne pranojmë rregullat e lojës në politikën që kanë ndërtuar këto dy partitë kryesore, nëse merr mandatin i bie që je patericë e qeverisë, nëse nuk e merr mandatin je palë me Lulin dhe Monikën. Në zgjedhjet e vitit 2017, pa u bërë marrëveshja PD-PS, ne si lëvizje politike hymë gartzani në garë pa bërë koalicion me asnjë nga partitë parlamen-

tare, duke thënë se do t'i bënim opozitë këtij sistemi parlamentar dhe politik të krijuar në Shqipëri. Në këtë këndvështrim, çdo mundësi që do të na jepej, të paktën mua personalisht, për të goditur të keqen që është ndërtuar, do ta bëja me shumë kënaqësi", - deklaroi Bojaxhi. Por sipas përfaqësuesit të PS-së në KQZ, Eridian Salianji partitë politike që s'kanë marrë 3 për qind të votave nuk mund të përfshihen në ndarjen e mandateve. Këtu përfshihet edhe Sfida e cila nuk arriti ta kalojë pragun.

ata Shqipërinë nuk e kthejnë dot më pas. Rrugën e Shqipërisë për të shkuar përpara nuk e hedhin dot më në erë. Nga veprimet e tyre dëmtohen njerëzit e zakonshëm, ata që merren me tregti, dëmtohen konsumi. Të jeni të sigurt se ne jemi me të drejtën dhe do të jemi edhe më shumë njerëz", - u shpreh kryeministri. Përkundër nevojës për të ulur tonet e debatit politik në vend dhe deklaratave të tija të dy ditëve më parë për dialog, kryeministri nuk ka nguruar sërish që të akuzojë

opozitës si përfaqësuese e fenomeneve më negative në vend, që nga droga e deri te lojërat e fatit. "Lufta jonë kundër kanabisit dhe lufta për reformën në drejtësi ka futur në panik shumë njerëz. Lufta kundër lojërave të fatit. Janë të gjitha këto forca të prekura përfaqësohen nga ata që thonë po lëmë mandatet dhe po shkojnë me popullin", - deklaroi Rama. Sa u përket zgjedhjeve të ardhshme vendore, ai u shpreh i sigurt në fitoren e PS-së edhe në Gjirokastër, por duke mos kritikuar kryebashkiaken

Zamira Rami. "E kemi fituar Bashkinë e Gjirokastrës në koalicion, por shumë gjëra që nuk janë bërë me ne, do të ecnin shumë më shpejt dhe do të bëhen shumë më mirë sapo të vijmë zgjedhjet e

ardhshme. Ne e dimë shumë mirë se Shqipëria që kemi nuk është ajo që duam, por është si dita me natën me atë që kishim, kështu do jetë edhe Gjirokastra", - u shpreh Rama.

**NJOFTIM ANKANDI**

**Përbaruesi Gjyqësor Lekë Dodaj** shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të palës debitore, si më poshtë:

1. Garazhit 68/55-G9, zona kadastrale 3292, volumni 25, faqe 39, ndodhur në Seltë Tiranë në pronësi të **Z.Besnik Abaz Hoshafi**.

**Cmimi me të cilin do të fillojë Ankandi i Parë është 5,681 (pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një Euro).**

Ankandë zhvillohet në datën **05.03.2019, Ora 16.00** në zyrën e Përbaruesit Gjyqësor Lekë Dodaj në adresën Rruga "Astrit Balluku", Ndërtesa 2, Hyrja 25, pranë Gjykatës së Fretheit Gjyqësor Tiranë.

**Për kontakt: 067.39.00.666, dhe në adresë emaili [leka\\_dodaj@hotmail.com](mailto:leka_dodaj@hotmail.com).**

**Shoqëria përbarimorë JUSTITIA**

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e PARË, për shirjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vënë hipotekë BK1 BANK, me këto të dhëna:

Pasuria "ARE" nr. 17/5, Zona Kadastrale 3339, me sipërfaqe 7780 m<sup>2</sup> faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Durrës, në pronësi të Z.Adrian Sefer Kapllani dit.08.03.1969, zj.Merita Myzafer Kapllani dit.24.06.1970 i Në Vlerën 11.600.000 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind mijë) Lekë.

Pasuria Apartament me sip.120m<sup>2</sup> nr.pas.41/150-1-1 z.k.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh /13 Durrës në pronësi të Z.Adrian Sefer Kapllani dit.08.03.1969.

Në vlerën 5.381.856 (pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) Lekë.

Ankandë zhvillohet në datën 07.03.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall.21.Shk.3, Ap.18, Tiranë.

**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service"** me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 15.03.2019 ora 8:00 - 16:00 në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandë i II-të për shirjen e 4 pasurive të paluajtshme, në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K me vlera filltare në ankand: a)176,867.6 (Njëqind e shtatëdhjet e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjet e shtatë pikë gjashtë) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2.795 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/66, Vol.18, Fq.152, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K. b)171,172.4 (Njëqind e shtatëdhjet e një mijë e njëqind e shtatëdhjet e dy pikë katër) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2.705 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/67, Vol.18, Fq.153, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K. c) 221,480 (Dyqind e njëzet e një mijë e katërqind e tetëdhjet) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 3.500 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/72, Vol.19, Fq.146, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K. d)94,920 (Nëntëdhjet e katër mijë e nëntëqind e njëzet) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 1.500 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/73, Vol.19, Fq.147, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**B**anka e Shqipërisë ngre shqetësimin për situatën ekonomike në vend. Sipas guvernatorit Gent Sejko, mungesa e stabilitetit nuk i shërben aspak rritjes ekonomike dhe përshpejtimin të reformave. "Natyrshisht, çdo krizë politike, çdo destabilizim politik do të kishte edhe efektet e tilla në ekonomi. Ne si Bankë Qendrore jemi të interesuar dhe bëjmë thirrje që të ketë gjithmonë stabilitet politik në mënyrë që ekonomia, reformat dhe prosperiteti i gjithë parashikimeve tona për një

**Mesazhi i guvernatorit të Bankës së Shqipërisë**

**Sejko: Çdo destabilizim politik sjell efekte në ekonomi**

rritje ekonomike të vazhdojë në mënyrë të suksesshme", - thekson Sejko pas ceremonisë së zhvilluar në ambientet e Bankës së Shqipërisë për promovimin e librit "Paraja, bankat dhe shoqëria. Bashkudhëtimi historik që nga fillimet deri në kohët moderne", të autorëve prof. dr. Aristotel

Pano dhe akad. prof. dr. Anastas Angjeli. Edhe akademiku Anastas Angjeli vuri theksin në rëndësinë e qëndrueshmërisë fiskale e monetare në një kohë që politika shqiptare është e përfshirë nga tensionet. "Zbatimi me konsekuencë i sistemit tonë monetar, bankar, stabiliteti dhe qëndrueshmëria

monetare fiskale edhe në kushtet e tronditjeve politike janë të domosdoshme dhe duhet të jenë në vëmendjen e të gjithëve", - tha Angjeli. Ndërkohë, dy ditë më parë Departamenti i Shtetit i bëri dje thirrje opozitës në Shqipëri të mos i dorëzojë në masë mandatet dhe të dënojë publikisht dhunën e ushtruar gjatë



protestave. Ndërkohë, përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Europian, Federica Mogherini dhe komisioneri për Zgjerimin Johannes Hahn, u shprehën se vendimi i opozitës për heqjen dorë nga mandatet

e tyre pengon seriozisht funksionimin e demokracisë në Shqipëri. Disa ditë më parë edhe Dhoma Amerikane apeloj për stabilitet politik, i cili i shërben kllimës së mirë ekonomike të një vendi.

Ministrja e Financave: Politikat fiskale do të jenë të paralajmëruara dhe të kalkuluara mirë

**M**inistria e Financave do të ka parashikuar që gjatë vitit 2019 të shlyejë 19 miliardë lekë detyrime të prapambetura. Lajmi u bë i ditur nga ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, gjatë një takimi me Dhomën Amerikane të Tregtisë. "Kam ndjekur me vëmendje të gjitha shqetësimet tuaja dhe një nga përpjekjet të rëndësime në drejtim të trajtimit të barabartë të sipërmarrjeve dhe transparencës do të jetë shlyerja detyrimeve të prapambetura. Në këtë drejtim po analizojmë me kujdes situatën, për t'i dhënë një zgjidhje sistemike problematike që lidhet me detyrimet e prapambetura. Për vitin 2019 kemi planifikuar 19 miliardë lekë, që përbën një shifër rekord në planin e rimbursimit dhe jemi duke ndjekur një skedul të qartë për zbatimin e tij. Ministria e Financave dhe Ekonomisë po monitoron nga afër planin e shlyerjes dhe metodologjinë e pagesave dhe vetëm në janar 2019 janë rimbursuar 1.7 miliardë lekë, niveli më i lartë i dhënë në terma mujore", deklaroi ministrja.

**INFORMALITETI**

Lufta kundër informalitetit dhe konkurrencës së pandershme nuk duhet të jetë "ad hoc", e ndërthur në aksione të ndërmarrja në mënyrë sporadike. Gjatë një takimi me Dhomën Amerikane e Tregtisë, ministrja e Ekonomisë dhe Financave, Anila Denaj, deklaroi se tashmë ka ardhur koha e një hartimi të një strategjie afatmesme, ku politikat fiskale të parashtrajnë vizionin dhe masat ndaj biznesit të jenë të paralajmëruara dhe mirë kalkuluara. "Përpjekjet tona në këtë drejtim do të fokusohen në qasjen sistemike përmes fokusimit në sistemet e monitorimit të riskut. Implementimi i sistemeve të auditimit dhe rafinimi i profileve të riskut do të jenë disa nga faktorët kyç në drejtim të suksesit për formalizimin e ekonomisë dhe antiinformalitetit. Përmirësimin e mëtejshëm të procedurave fiskale, nëpërmjet thjeshtësimit të mëtejshëm të legjislacionit të agjencive

**Borxhet, Denaj: Për vitin 2019 kemi planifikuar 19 miliardë lekë**


*Nis shlyerja e detyrimeve të prapambetura për bizneset*



Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, gjatë një takimi me Dhomën Amerikane të Tregtisë

që mbledhin të ardhurat. Rritja e transparencës duke bërë informacionin për takapaguesin sa më të aksesueshëm dhe 'user-friendly' përmes platformave "online", - tha ministrja. Denaj deklaroi se qeveria shqiptare i jep një rëndësi të veçantë marrëdhënieve me biznesin dhe dëshmi e qartë janë të gjitha reformat strukturore që janë ndërmarrë vitet e fundit në të gjithë sektorët e ekonomisë, regjimit fiskal dhe veçanërisht në reduktimin e praktikave burokratike për tërheqjen e investimeve, si dhe rritjen e konkurrenshëmërisë si faktor kyç për zhvillimin ekonomik.

latoi se qeveria shqiptare i jep një rëndësi të veçantë marrëdhënieve me biznesin dhe dëshmi e qartë janë të gjitha reformat strukturore që janë ndërmarrë vitet e fundit në të gjithë sektorët e ekonomisë, regjimit fiskal dhe veçanërisht në reduktimin e praktikave burokratike për tërheqjen e investimeve, si dhe rritjen e konkurrenshëmërisë si faktor kyç për zhvillimin ekonomik.



Sipas metodës së BE-së, inflacioni i janarit ishte 2.4%

Inflacioni në muajin janar sipas matjeve që referohen nga EUROSTAT ishte 2.4%. Ky nivel është më i lartë se matjet kombëtare në të cilat u raportua se çmimet në janar u rriten me 1.9%. Sipas metodës së BE-së, rritja më e madhe e çmimeve prej 5.4%, vërehet në grupet "Ushqime dhe pije joalkoolike", pasuar nga grupet "Hotele, kafene dhe restaurante" me 2.9%, "Argëtim dhe kulturë", me 1.8%, "Pije alkoolike dhe duhan" me 1.1%, "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me 0.5%, "Mallra dhe shërbime të ndryshme" me 0.4%, etj. Nga ana tjetër çmimet e grupit "Transporti" u ulën me 0.6%, pasuar nga grupet "Veshje dhe këpucë" dhe "Shëndeti" me 0.5% secili. Në muajin janar 2019, ndryshimi mujor i matur nga indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është 2.3%. Ky ndryshim është ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të grupit "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 6.5%, pasuar nga grupet "Pije alkoolike dhe duhan", "Veshje dhe këpucë" dhe "Mallra dhe shërbime të ndryshme" me 0.2% secili. Ndërsa, çmimet e grupit "Transporti" u ulën me 0.7%, pasuar nga grupet "Argëtim dhe kulturë" me 0.4% dhe "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me 0.2%. Për të ndihmuar më hartimin e politikave dhe për të realizuar një krahasueshmëri sa më të mirë me vendet e tjera, në bashkërendim me EUROSTAT, INSTAT ndër-mori hap në drejtim të krijimit të një baze të përbashkët metodologjike të shteteve anëtare për ndërtimin dhe përdorimin e IHÇK-së, sipas Rregullores së Këshillit Europian (KE), nr. 2494/95, të datës 23 tetor 1995.

**ÇMIMET**

Sipas metodës së BE-së, rritja më e madhe e çmimeve prej 5.4%, vërehet në grupet "Ushqime dhe pije joalkoolike", pasuar nga grupet "Hotele, kafene dhe restaurante" me 2.9%...

**APP vetëm tërheq vëmendjen e institucioneve**

**Abuzimi me mallrat e tenderave, s'përputhen me kërkesat e garës**

Mallrat apo artikujt e dorëzuar pranë institucioneve shtetërore nga kompanitë që fitojnë tendera publikë nuk janë sipas specifikimeve teknike mbi bazën e të cilave janë paragrafitur, vlerësuar dhe shpallur fitues. Konstatimi nga ardhur nga Agjencia e Prokurimit Publik, pas analizimit të formularëve të dërguar nga autoritetet kontraktore, mbi procesin e zbatimit të kontratave si dhe raportet e monitorimit të përcjella nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.



Nisur nga kjo situatë, APP është mjaftuar duke kërkuar nga autoritetet kontraktore që të verifikojnë mallrat e dorëzuar, nëse ato përputhen me specifikimet e bëra gjatë garës tenderuese. Por, nuk ka sh-

kuar më tej për të analizuar nëse në këtë rast kemi elementë të garës së pandershme, duke qenë se operatorët e ekonomikë duhet të përmbushin kriteret e përcaktuar për t'u shpallur fitues. Si pasojë e këtyre shkeljeve, mund të përjashtohen nga gara operatorët ekonomikë që paraqesin oferta më të ulëta, çka do të sillte edhe më pak shpenzime për një shërbim të caktuar dhe nga ana tjetër dëmtohet konkurrenca e ndershme mes kompanive, si pasojë e skualifikimeve të padrejta.



**Manastirliu: Punësim mbi bazë merite**

**Mjekët dhe infermierët ekselentë, hyjnë në konkurrimin për punë me 10 pikë bonus**

**C**do student ekselent i Universitetit të Mjekësisë apo Infermierisë, do të hyjë në procedura konkurrimi për t'u punësuar në qendra shëndetësore ose spitale publike, me 10 pikë bonus. Deklarata u bë ditën e djeshme nga ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, gjatë ceremonisë së diplomimit të studentëve të tre Fakulteteve të Mjekësisë dhe Fakultetit të Infermierisë në Tiranë.

**10**

**PIKË BONUS**

Cdo student ekselent i Universitetit të Mjekësisë apo Infermierisë, do të hyjë në procedura konkurrimi për t'u punësuar ose spitale publike, me 10 pikë bonus. Deklarata u bë ditën e djeshme nga Ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu.

**KËRKESAT E STUDENTËVE**

Manastirliu theksoi se do të përbushen një për

një të gjitha angazhimet e marra nga qeveria. "Puna e nisur nuk do të ndalet derisa të realizohet çdo an-

gazhim, që nga përmirësimi i kushteve në konvikte, te biblioteka dixhitale, te tarifet e studentëve, transparenca e buxheteve, punësimi i studentëve ekselentë dhe krijimi i mundësive të barabarta për punësim", tha Manastirliu. Gjithashtu, ministrja e Shëndetësisë deklaroi se do të garantohet që çdo profesionist, të punësohet me meritë. "Prej një viti po konsolidojmë portalin 'Infermierë për Shqipërinë',



ndërsa jemi duke punuar për krijimin e portalit 'Mjekë për Shqipërinë', ku do të bëhen transparente vendet vakante dhe do të ofrohet më shumë mundësi përzgjedhjeje për mjekët e rinj, për t'u punësuar në sistemin shëndetësor publik", tha në fjalën e saj Manastirliu. Gjatë ceremonisë së zhvilluar në Pallatin e Kongreseve, u diplomuan 591 studentë të 3 fakulteteve të mjekësisë dhe 1560 studentë të Infermierisë dhe shkencave mjekësore teknike.

**Thjeshtëzime edhe për ata që kanë jetuar në Greqi ilegalisht për 7 vjet**

**Projektligji për nënshtetësinë greke pret miratimin, lehtësirat për emigrantët**

*Ja sa do të ulen tarifet për kryerjen e procedurave*

Voltiza Duro

**P**rojektligji i ri për nënshtetësinë greke është dërguar për miratim në sekretariatit dhe qeverisë dhe prej andej pritet që në ditët e ardhshme të dorëzohet në parlament për votim. Fillimisht, përgatitja e ligjit të ri ishte paralajmëruar nga sekretari i përgjithshëm për nënshtetësinë, Lambros Baltisotis. Informacioni për futjen e projektligjit në procedurën e votimit, është dhënë nga zyra e ministrit të Brendshëm, Aleksis Haritsis.

**DISPOZITAT LEHTËSUESE**

Projektligji përmban dispozita që i shërbejnë racionalizimit, thjeshtëzimit dhe unifikimit të procesit të natyralizimit (politografisë). Më konkretisht, aplikuesit do të ftoheshin të përgjigjen në 20 pyetje nga 30 që do t'u bëhen gjithsej. Pyetjet do të jenë rreth gjuhës, gjeografisë, historisë, institucioneve politike, zhvillimeve aktuale politike. Këto pyetje do të përzgjidhen rastësisht nga një "bankë" prej 300 pyetjesh të parapërgatitura, përgjigjet e të cilave do të jenë të gjitha të disponueshme për të interesuarit, në një faqe interneti. Hartuesit e projektligjit thonë se kjo është një praktikë që zbatohet gjerësisht në SHBA dhe në mjaft vende të Europës. Me testin e ri, arrihet një reduktim maksimal i shkrimit të protokollit, që sot shkon deri në tre muaj. Në të njëjtën kohë sanksionohet një test unik për njohjen e gjuhës greke, me qëllim që të gjithë ata, të cilët pas testit gjykohej se kanë njohuri të mjaftueshme, të mos testohen nga komisioni i natyralizimit.

**REDUKTIMI I TARIFAVE**

Më tej, reduktohet tarifa (paravolo) që paguajnë aplikantët për marrjen e nënshtetësisë greke. Paravolo e re do të jetë 550 euro, në vend të 700 që është deri më tani. "Një tjetër risi është se gjithë ata që kanë dëshmuar lidhje të ngushta me Greqinë, por mu-



nojnë për 18 muaj nga Greqia. Nëse këta kishin aplikuar më përpara për marrjen e nënshtetësisë, procedura pezullohet dhe aplikimi mund të rishqyrtohet në rast se këta vendosen sërish në Greqi. Për "alogenët" (ata që nuk kanë origjinë greke), vendimi për natyralizimin do të merret tashmë nga drejtoria e nënshtetësisë e periferisë, gjë që pritet të reduktojë deri në 9 muaj kohën e pritjes, bëjnë me dije ekspertët. Në dispozitat e reja përfshihen edhe ato që kanë të bëjnë me përshatjen e legjislacionit grek me kuadrin institucional europian. Në këtë drejtim, ka dispozita që u japin të drejtën e marrjes së nënshtetësisë personave me moshë të shkuar, personave me të meta mendore, apo të sëmurëve psikikë. Sipas të dhënave zyrtare, janë rreth 200.000

**Aplikuesit do të ftoheshin të përgjigjen në 20 pyetje nga 30 që do t'u bëhen gjithsej. Pyetjet do të jenë rreth gjuhës, gjeografisë, historisë, zhvillimeve aktuale politike). Këto pyetje do të përzgjidhen nga një "bankë" prej 300 pyetjesh të parapërgatitura.**

qytetarë të ardhur nga Shqipëria që kanë përfutur nënshtetësinë greke.

**MARRJA E NËNSHTETËSISË**

I pyetur nga 'Gazeta Shqiptare', eksperti Fatos Malaj, tregon se procedura për kryerjen e shkëputjes nga leja e qëndrimit, mund të kryhet automatikisht. "Në momentin që një emigrant shqiptar merr nënshtetësinë greke, kjo parqitet në gazetën qeveritare. Para funksionontë në këtë mënyrë: emigranti duhet të shkonte në Qendrën e Emigracionit ku dhe kishte marrë lejen e qëndrimit, dhe bënte shkëputjen nga kjo leje në mënyrë që të merrte nënshtetësinë. Por kjo ishte një procedurë që zgjaste 2-3 javë. Tashmë procedura është lehtësuar dhe bëhet automatikisht", - thotë Malaj. Megjithatë heqja e lejes së qëndrimit mund të duket një veprim i thjeshtë, në fakt njerëzve u kushtonte shumë, sidomos të

**LEHTËSIRAT**

"Të gjithë ata që kanë jetuar në shtetin helen ilegalisht për më shumë se 7 vjet dhe dëshirojnë të marrin leje qëndrimi procedura do të thjeshtëzohet. Para iu duhet të dorëzoni dokumente vërtetimi që këta emigrantë dëshmonin se kishin qëndruar në Greqi për më shumë se 7 vjet. Tashmë kjo kategori emigrantësh duhet të dorëzojë vetëm vërtetimin që prej 7 vjetësh jetojnë në shtetin fqinj", - tregon Malaj.

**TARIFAT**

Reduktohet tarifa që paguajnë aplikantët për marrjen e nënshtetësisë greke. Paravolo e re do të jetë 550 euro, në vend të 700 që është deri më tani. "Një tjetër risi vjen për të gjithë ata që kanë dëshmuar lidhje të ngushta me Greqinë, por mungojnë për 18 muaj nga Greqia. Nëse këta kishin aplikuar më përpara për marrjen e nënshtetësisë, procedura pezullohet dhe aplikimi mund të rishqyrtohet në rast se këta vendosen sërish në Greqi."

rinjve të brezit të dytë që mund të kishin shans për të shfrytëzuar programe studimi jashtë shtetit, dhe nuk pajiseshin në kohën e duhur me këtë dokumente greke. Kjo sepse nuk mund të paraqiteshin direkt në zyrat e shtetasve të huaj dhe emigracionit, por duhej që më parë të linin një takim e cili mund të realizohej edhe pas disa muajsh. Ndërkaq edhe mbajtësit e "kartës së homojenit", duhej të paraqiteshin në polici për të anuluar kartën e tyre. Pra, gjithë kjo procedurë sillte një zvarritje të panevojshme, në një kohë që gjithçka mund të zgjidhej në mënyrë elektronike nga shërbimet administrative greke. Gjithashtu, ndërjetësi ndërkulturor Malaj tregon për "GSH" se janë krijuar

lehtësira edhe për emigrantët që aplikojnë për leje qëndrimi për arsye të jashtëzakonshme. "Kemi arritur që brenda një viti të sjellim lajme të mira edhe për emigrantët që aplikojnë për leje qëndrimi për arsye të jashtëzakonshme. Të gjithë ata që kanë jetuar në shtetin helen ilegalisht për më shumë se 7 vjet dhe dëshirojnë të marrin leje qëndrimi procedura do të thjeshtëzohet. Para iu duhet të dorëzoni dokumente vërtetimi që këta emigrantë dëshmonin se kishin qëndruar në Greqi për më shumë se 7 vite, ku përfshiheshin edhe kontratat e qirasë apo të punës. Tashmë kjo kategori emigrantësh duhet të dorëzojë vetëm vërtetimin që prej 7 vjetësh jetojnë në shtetin fqinj", - tregon Malaj.

**TIRANË** - Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpalli dje moskompetencën për shqyrtimin të kërkesës së Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim për shkarkimin e kryeprokurores, Arta Marku, të cilën e akuzojnë për shkelje të rënda në detyrë. Pas shumë diskutimesh në mbledhjen që u zhvillua me dyer të mbyllura, qeveria e prokurorëve autorizoi kryetarin e saj, Gent Ibrahim



## Kërkesa e PD-LSI për shkarkimin e Arta Markut, KLP: Nuk jemi kompetente për ta shqyrtuar

t'iu kthejë përgjigje zyrtare subjekteve politike. Në një deklaratë për mediat kreu i KLP, Gent Ibrahim nuk dha komente për institucionin kompetent për shqyrtimin e kërkesës së opozitës, ndërkohë që deklaroi se përgjigja është dhënë në shkresën e cila bëhet publike

ditën e sotme. Referuar nën titullin 149 pika "c" e Kushtetutës, është Gjykata Kushtetuese institucioni që shkarkon kryeprokuroren, në rastet kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike, apo është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Opozita pretendon se kryeprokuroria e përkohshme ka abuzuar me detyrën. Më 29 janar të këtij viti, grupet parlamentare të PD dhe LSI deponuan një kallëzim penal për kryeprokuroren e përkohshme Arta Marku, për shkelje ligjore në zgjedhjen e Bujar Sheshit

anëtar të KLP-së i cili ka rezultuar se ka qenë bashkëpunëtor i sigurimit të shtetit. Megjithatë kërkesa e bërë nga dy subjektet politike për shkarkimin e Markut nuk mund të shqyrtohet, për shkak se Gjykata Kushtetuese prej muajsh është jashtë funksionit. Gjatë kësaj periudhe derisa Kushtetuesja të nisë Kushtetuesen të fillojë të funksionojë, Shqipëria mund të ketë kryeprokurorenin e ri me mandat kushtetues.

20 të mitur u dërguan në Romë, kundrejt pagesës nga 700 deri në 1000 euro

# Trafikimi i fëmijëve shqiptarë në Itali, arrestohet punonjësi i "Alitalia"

## Në pranga dhe djali i tij i adoptuar

ITALI

Një punonjësi i një kompanie fluturimi dhe djali i tij i adoptuar janë arrestuar, pasi akuzohen se kanë trafikuar fëmijë shqiptarë drejt Italisë dhe përmashtim. Sipas mediave italiane, në pranga janë vendosur punonjësi i kompanisë "Alitalia", S.B., dhe djali i tij i adoptuar, A.R., me origjinë shqiptare. Të dy ata, duke përfutur nga zbritjet e ofruara për të afërmit e punonjësve të linjës ajrore, kanë dërguar drejt Romës rreth 20 fëmijë, mes viteve 2014 dhe 2016. Ata u kërkonin familjarëve të fëmijëve që të paguanin një shumë që varionte nga 700 deri në 1 mijë euro. Ndërsa prindërit pranonin, pasi kërkonin t'iu ofronin fëmijëve një të ardhme më të mirë. Ndërkohë, fëmijët shqiptarë u mirëpritën nga



Bashkia e Romës si fëmijë të braktisur. Sipas prokurorit Marcello Cascini, udhëtimet janë bërë me bileta falas nga kompania "Alitalia", sepse dy të pandehurit deklaruan në mënyrë të rreme se ishin baba dhe djale. Ndonëse i pandehuri

ri deklaroi se e ka adoptuar ligjërisht shqiptarin me inicialet A.R.. Gjithashtu, ata u kërkonin shërbimeve sociale të Bashkisë së Romës asistencë për të ndihmuar disa nga fëmijët që ishin shpallur të braktisur, ndërkohë që

UDHËTIMI

Sipas prokurorit Marcello Cascini, udhëtimet janë bërë me bileta falas nga kompania "Alitalia", sepse dy të pandehurit deklaruan në mënyrë të rreme se ishin baba dhe djale. Ndonëse i pandehuri deklaroi se e ka adoptuar ligjërisht shqiptarin me inicialet A.R.. Gjithashtu, ata u kërkonin shërbimeve sociale të Bashkisë së Romës asistencë për të ndihmuar disa nga fëmijët që ishin shpallur të braktisur, ndërkohë që prindërit u kishin dhënë atyre kujdestarinë.

prindërit u kishin dhënë atyre kujdestarinë. Bashkia e Romës, e cila mori përsipër të gjitha shpenzimet e fëmijëve, pësoi një dëm serioz pasi shpenzimet përlogaritshin rreth 85 euro në ditë për fëmijë, për disa vite.



Çelnik Shaholli në gjykatë

## Vrau nënën e 6 fëmijëve të tij me mjete prerëse, çohet në gjykatë dosja e Çelnik Shahollit

**TIRANË** - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka dërguar dje në gjykatë dosjen në ngarkim të të pandehurit Çelnik Shaholli, i akuzuar për veprën penale: "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare". Ngjarja e rëndë ndodhi mbrëmjen e 9 qershorit të vitit 2018 në banesën e familjes Shaholli, në Kënetë të Durrësit. 40-vjeçarja Adriana Shaholli, nënë e 6 fëmijëve është grindur me bashkëshortin Çelnik Shaholli 42-vjeç, pasi kishte filluar punë në një lavanderi. Çelnik Shaholli mësohet të jetë bërë xheloz për punën e bashkëshortes dhe e akuzonte të ndjerën se kishte marrëdhënie me pronarin. Në sherr e sipër, ai e ka shtyrë, ndërsa gruaja ka përplasar kokën në dysheme. Çlirim Shaholli e çoi me duart e tij në urgjencë bashkëshortin e plagosur. Mjekët vunë re një hematomë në kokë, ndërsa gruaja nuk mundi të dilte e gjallë nga salla e operacionit. Pas shoqërimit në polici burri pranoi që ishin zënë. Ai e kishte shtyrë dhe ajo kish përplasar kokën në dysheme. "Nuk doja ta vrisja, si mund të lija jetim fëmijët e mi", - mësohet të ketë thënë ai në polici. Por nga hetimet e Prokurorisë rezultoi se e ndjera është vrarë me mjete të forta prerëse.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,840.000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfytuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **19 Mars 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## TEC në Korçë, bashkia në mbështetje të banorëve: Jasthtë qytetit, të mos ketë ndotje për zonën

**KORÇË** - Pas kundërshtrive të banorëve dhe ambientalistëve për ndërtimin e termocentralit në qytet kanë reaguar edhe përfaqësuesit e pushtetit lokal. Kryebashkiaku dhe prefekti mbështesin ndërtimin e veprës në qytet vetëm nëse shoqërohet me zgjidhje për ngrohjen dhe nëse niveli i ndotjes është sipas parametrevë të BE-së. Në mbështetje të banorëve të Korçës dhe ambientalistëve, të cilët e kanë kundërshtuar ndërtimin e Termocentralit pasi krijon ndotje mjedisore, janë rreshtuar edhe përfaqësuesit e pushtetit lokal. Kreu i Bashkisë, Sotiraj Filo e kundërshton ndërtimin e TEC-it në qytet nëse nuk sjell përfitime për ngrohjen. Filo është shprehur se nuk ka aspak kompromis nëse TEC-i nuk shërben për ngrohjen e banorëve të Korçës dhe më pas mbetet për të analizuar nive-

lin e ndotjes për të vendosur nëse do të ndërtohet apo jo në qytet. I të njëjtit mendim është edhe prefekti Dhori Spirollari. Edhe pse mbështet investimet strategjike për zonën, Spirollari këmbëngul që kompania investitore të japë garanci që niveli i ndotjes të jetë sipas parametrevë të BE-së. Vepra e re energjetike, investimi prej 400 milionë euro i një kompanie austriake që parashikohet të ndërtohet në afërsi të impiantit të ujërave të përdorura ka ndezur polemikë në Korçë. Qytetarët dhe ambientalistët janë shprehur kundër këtij investimi, pasi rrezikon t'i shkaktojë Korçës ndotje mjedisore në nivele të larta.



Babai i 4 fëmijëve mohoi akuzat, jepet masa e sigurisë "Detyrim paraqitje"

SHKODËR

Gjykata e Shkallës së Parë e Shkodrës dje ka lënë të lirë inspektorin e Gruemirës në Malësinë e Madhe, Berhan Bajrakurtaj, i cili u arrestua afro dy javë më parë pas publikimit të një videoje intime, ku pretendohet se 53-vjeçari ngacmonte seksualisht një 15-vjeçare përmes telefonit. Pavarësisht se efektivit i policisë i mohoi akuzat duke u shprehur se nuk ka ngacmuar asnjë të mitur, më 14 shkurt togat e zeza të qytetit verior vendosën lënie e tij në burg me afat 30 ditë. Ndërkaq, paraditen e djeshme është bërë rivlerësimi i masës së sigurisë ndaj Barakurtajt nga gjykata për të mitur, e cila vendosi ndaj tij masën "Detyrim paraqitje". Lirimi i inspektorit të Policimit në Komunitet, Berhan Bajrakurtaj, u la i lirë pasi deri tani askush nuk i është drejtuar policisë për të marrë përsipër akuzat dhe për të zyrtarizuar denoncimin. Për këtë, grupi hetimor ka dyshime se mund të bëhet fjalë për një lajm të rremë. Seanca e djeshme gjyqësore për rivlerësimin e masës së sigurisë është zhvilluar me detyrë të mbyllura, ndërsa burime pranë togave të zeza bëjnë me dije se polici ka mohuar të ketë ngacmuar ndonjë person. Bajrakurtaj u dërgua në gjykatë me ambulancë, pasi ka shfaqur probleme shëndetësore, kryesisht cardiake. Kjo ka qenë edhe një nga arsyet që gjykata ndryshoi masën e sigurisë. Nga ana tjetër, policia pretendon se mbi këtë çështje nuk ka marrë asnjë denoncim nga ndonjë banorë e zonës, apo nxënëse në Malësinë e Madhe.

**DËSHMIA E POLICIT**  
Në seancën e kaluar, gjykata qytetit verior e la në qeli babain e katër fëmijëve. Vendimi u mor pas kërkesës së prokurorit Vat Staka për kryerjen e akt-ekspertimit të telefonit të efektivit të Malësinë së Madhe. Në atë seancë, gjykata shpalli dhe moskompetencë për këtë çështje, duke ia kaluar për shqyrtim gjykatës për të mitur, duke bërë që automatikisht të mbetet në fuqi kërkesa e prokurorit për masë sigurie "burg me afat". Në sallën e gjyqit, Berhan Bajrakurtaj ka mohuar akuzën për ngacmim seksual ndaj një vajze 15-vjeçare, duke thënë se nuk ka asgjë të vërtetë në këtë mes. Polici ka deklaruar se ai ka qenë në shtëpi kur ka regjistruar videon, që më pas u publikua në media dhe se materialin filmik nuk ia ka dërguar askujt. Lidhur me faktin se si kanë dalë në publik këto pamje, 53-vjeçari ka thënë se disa ditë para kësaj ngjarjeje, e kishte dërguar celularin e tij në një servis për ta rregulluar. Por pavarësisht se i kishte vendosur

# Videoskandali, gjykata liron inspektorin e policisë së Gruemirës, Berhan Bajrakurtaj

*Nuk ka asnjë denoncim për videon intime. Hetuesit: Ka dyshime se është lajm i rremë*



Berhan Bajrakurtaj

kod, ai dyshohet se mund t'i kenë kopjuar videot që kishin të ruajtura. Pas asaj seance ka reaguar ashpër vëllai i efektivit të policisë, Afrim Bajrakurtaj. Ky i fundit mohoi se vëllai i tij kishte

ngacmuar një të mitur, ndërsa u shpreh se çdo gjë është e stisur dhe e montuar. Afrim Bajrakurtaj akuzoi mediat për manipulim dhe tha se kjo është bërë për ta dëmtuar. "Me të miturën nuk ka

## AKUZATE VËLLAIT TË POLICIT

Vëllai i efektivit të policisë, Afrim Bajrakurtaj ka reaguar për mediat, duke mohuar se vëllai i tij kishte ngacmuar një të mitur, ndërsa u shpreh se çdo gjë është e stisur dhe e montuar. Afrim Bajrakurtaj akuzoi mediat për manipulim dhe tha se kjo është bërë për ta dëmtuar. "Me të miturën nuk ka punë, në pastë punë ai, nuk është vëllai ynë. Nuk është vëllai ynë, po pat punë me të mitur. Por nuk ka, ato janë rrena të tana, skenarë tuajët, të mediave. Jena 300 meshkuq që na vjen marre me dalë dhe në rrugë të madhe. Videoja është e bërë, e manipuluar nga mediat, nga ju. Ta hiqni videon se keni përgjegjësi. U njëfsha të mirën!", deklaroi vëllai i inspektorit të policisë.

punë, në pastë punë ai, nuk është vëllai jonë. Por nuk ka, ato janë rrena të tana, skenarë tuajët, të mediave. Videoja është e bërë, e manipuluar nga mediat, nga ju. Është e qëndrueshme, në na kanë rënë bombë. Në s'kemi dalë jashtë, tash tri ditë. Jena 300 meshkuq që na vjen marre me dalë dhe në rrugë të madhe.

E kanë bërë me qëllim për ta dëmtuar. Në nuk i kemi gjë kujt borxh. Unë dal hapur, nëse vëllai ynë e ka bërë prapë atë punë, mos e nxjerr të kryet, s'na duhet ne gjë më. Por nuk e ka bërë, është manipulim mediash. Ta hiqni videon se keni përgjegjësi. U njëfsha të mirën!", u shpreh Afrim Bajrakurtaj.

## Gjendet i vetëvarur në qelitë e paraburgimit 23-vjeçari

**ELBASAN** - Një 23-vjeçar është gjetur i vetëvarur në qelinë e paraburgimit në Bradashesh të Elbasanit. Mësohet se i riu Bledar Doda u gjet i pajetë nga gardianët e burgut. Pavarësisht se ai është transportuar për në spital, ka qenë tepër vonë, pasi kishte ndërruar jetë. I riu nga Burreli prej 3 muajsh ndodhej në paraburgim, pasi ishte arrestuar për përndjekje. Ai kishte shfaqur prej kohësh shenja të depresionit, por ditën e sotme ka ndërmarrë veprimin ekstrem. Trupi i të riut pritet t'i nënshtrohet ekspertizës mjekoligjore në Tiranë për të hedhur më shumë dritë mbi ngjarjen.

## Shoqëria permbarimore JUSTITIA:

- Shpall ankandin, faza I, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilat ka vënë hipoteke NGB BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:
1. Pasuria me numër 5/1-B2, sip 115 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, K. Nëntokë, B2, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 454, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 25,600 (njëzet e pesë mijë e gjashtëqind ) Euro.
  2. Pasuria me numër 5/1-1-28, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP.28, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 448, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë ) Euro.
  3. Pasuria me numër 5/1-1-47, sip 53.2 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 7, AP.47, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 458, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 16,160 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë ) Euro.
  4. Pasuria me numër 5/1-1-47, sip 119.62m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, K. Nëntokë, B1, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 453, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 26,400 (njëzet e gjashtë mijë e katër qind) Euro.
  5. Pasuria me numër 5/1-1-45, sip 27.01 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP.45, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 456, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 8,240 (tetë mijë e dyqind e dyzet) Euro.
  6. Pasuria me numër 5/1-1-46, sip 26.45 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 7, AP.46, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 457, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 8,080 (tetë mijë e tetëdhjetë ) Euro.
  7. Pasuria me numër 5/1-1-49, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 4, AP.49, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 460, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 17,520 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet) Euro.
  8. Pasuria me numër 5/1-1-44, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 7, AP.44, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 447, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë ) Euro.
  9. Pasuria me numër 5/1-1-25, sip 67.73 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP.43, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 446, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.
  10. Pasuria me numër 5/1-1-23, sip 26.45 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP.25, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 445, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë ) Euro.
  11. Pasuria me numër 5/1-1-26, sip 53.2 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP.26, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 450, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 16,160 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë ) Euro.
  12. Pasuria me numër 5/1-1-48, sip 70.38 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP.48, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 459, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.
  13. Pasuria me numër 5/1-1-24, sip 27.01 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP.24, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 449, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë ) Euro.
  14. Pasuria me numër 5/1-1-23, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP.23, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 452, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë ) Euro.
  15. Pasuria me numër 5/1-1-22, sip 67.73 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP.22, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 455, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 21,680 (njëzet e njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) Euro.
  16. Pasuria me numër 5/1-1-27, sip 70.38 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP.27, Shëngjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 449, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndocaj. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.

Ankandi zhvillohet në datën 22.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e permbaruesit gjyqësor. Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studio-justitia.com, tel-+355 4 2270890

## Tjetër skandal, vidhen armë në magazinën e Ministrisë së Brendshme

**TIRANË** - Pas vjedhjes së armëve në Pashaliman, një tjetër vjedhje në përmasat e një skandali konstatohet në një magazinë në Ministrinë e Brendshme. Sipas "Ora News", bëhet fjalë për Qendrën e Furnizimit të Materialeve Teknike ish-reparti 100 në Mullet. Mësohet se në këtë magazinë, ku krahas materialeve të tjera mbahen edhe armë, të cilat përdoren nga efektivët është konstatuar mungesa e dy pistoletave të tipit të fundit. Mungesa e armëve është vënë re në muajin dhjetor të vitit të kaluar gjatë rikonstruksionit të objektit. Mësohet se dy nga valixhet ku ndodheshin armët u janë dukur të lehta personave që po merreshin me spostimin e materialeve dhe pasi i kanë hapur, kanë konstatuar se ishin të boshatisura. Pas kësaj ka nisur një audit ku është konkluduar se krahas dy pistoletave, janë vjedhur edhe materiale të tjera. Menjëherë çështja ka kaluar për t'u hetuar nga SHÇBA, e cila pasi ka kryer verifikimet, i ka referuar materialet në Prokurorinë e Tiranës. Referimi është bërë në muajin dhjetor, ndërsa i ka rënë për t'u hetuar prokurorit Elio Mazreku. Verifikimet kanë nisur për të përcaktuar kohën kur ka ndodhur vjedhja. Të dyshuar janë të gjithë personat që kanë pasur akses në magazinë si dhe ata që kanë pasur për detyrë ruajtjen e saj. Gjithashtu, valixhet ku mbaheshin armët janë dërguar për ekspertim në policinë shkenore për të gjetur gjurmët e shpirtit të personave që i kanë prekur për herë të fundit.



Ministria e Financave publikon listën me dosjet që ka shryrtuar nga janari deri në tetor 2018

# Ish-të përndjekurit, 5 mijë trashëgimtarët që marrin paratë

## Dokumentet që duhet të plotësojë çdo përfitues

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Financave. Janë në total 5 mijë përfitues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Pagesave nga janari deri në tetor të vitit të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e përfituesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar shënohet me "V" në rastet kur dokumenti është në rregull, me X kur është gabim dhe është kolona bosh kur dokumenti nuk është paraqitur.

### DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasin me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës

nga një certifikatë e një periudhe të caktuar; atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq është i domosdoshëm një vendim fakti gjykate që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative e lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave.

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETËR NJOFTI M	NUME R PERSO NAL LLOGA RI BANKA RE	CERTIF IKATE VDEKJ E	CERTIF I-KATE E TRUNG UT FAMIL JAR	DESHEM I TRASH GI-MIE	PRO- KURE	CERTIF IKATE PER CDO NDRYS HIM IDENTI TETI
Foto	Stavro	Aristidh	Karaxhoti	V	X					
Vasli	Stavro			V	V					
						V	V	V		
Xhëde	Çelaj					X	X	V		
Laje	Thorja	Falri	Thorja						P	
		Agim	Thorja						P	
		Setrije	Ishnaku						P	
		Osmari	Thorja						P	
		Xhevahire	Bincari						P	
		Melihu	Hasaj						P	
Sibe	Dashaj					X	X	V		
		Tahir	Dashaj						P	
		Rabije	Hamja						P	
		Fite	Buhaj						P	
		Selmanje	Hamja						P	
Sait	Çelaj			V	V				V	
Zyke	Dani								P	
Hyrrije	Alija					V	X	V		
		Shpresa	Gjataja						P	
		Kujtim	Alija						P	
		Iir	Alija						P	
		Slipetim	Alija						P	
						V	V	V		
Xhelal	Asllani					X	V	V		
Makbule	Asllani					X	V	V		
Donika	Lumi					V	X	V		
Xhezo	Asllani	Abru	Lumi	V	V					
				V	V					
						V	V	V		
Katrine	Lulish					X	X	V		P
		Tomir	Nika	V						
		Zoje	Nika	X	X					
		Gjergj	Nika	X	X					
		Soft	Nika	X	X					
Nake	Mihal			V					P	
						V	X	V		
		Mre	Nika	X	X					
		Edmont	Nika	V					V	
		Rozafa	Nika	X	X					
		Bledi	Nika	X	X					
Marje				V						P
						V	V	V		
Meropi	Xhoja					V	V	V		
Aleksander	Xhoja			V	X					
Aksinja	Xhoja			V	V					
						V	V	V		
Marianti	Konli					X	V	V		P
Spro	Konli			V						P
Stavrulla	Koça			V						P
Arifulla	Çarri			V						P
Mihal	Konli			V	V					V
						V	V	V		
Naun	Daja					X	V	V		
Kostandina	Daja					X	V	V		
Farje	20/12/1925			X	X					
Petro		Aleksander	Daja				V	V		
		Lamber	Daja							P
		Viktor	Daja							P
		Fatmirë	Daja	V	V					V
						V	V	V		
Ashe	Feza					V	V	X		

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETËR NJOFTI M	NUME R PERSO NAL LLOGA RI BANKA RE	CERTIF IKATE VDEKJ E	CERTIF I-KATE E TRUNG UT FAMIL JAR	DESHEM I TRASH GI-MIE	PRO- KURE	CERTIF IKATE PER CDO NDRYS HIM IDENTI TETI
Zenel	Feza					V	X	X		
Selme	Karaj									P
Rabushe	Hysa			V		V	X	X		
Fatime	Zhubina			V						P
Musa	Feza					V	X	X		
Xhemle	Koçi			V						P
Ismail	Feza			V	V					V
Mereme	Kasa			V						P
Gjylë	Ceka			V						P
Januz	Feza			V						P
Athina (Xhevrije)	Sulfi			V	V	V	V	V		V
Perie	Shehu			V	V					
Rrapo	Agallu			V	V					
Agathi	Koxhaj			V	V					
Ferrak	Agallu					V	X	X		
Jemine	Shehaj			V	V					
Merushë	Zyberli			V	V					
Nuredin	Agallu			V	V					
Vasil (Ylli)	Caci			V	V					V
						V	V	V		
Shaqe	Gjelaj			V	V					
Diell	Prenga			V	V					
File	Rudj					V	V	V		
		Age	Ndoci	X	X					
		Vera	Palaj	V	V					
		Mark	Rudi	V	X					
		Vasil	Rudi	V	X					
						V	V	V		
Sofia	Kaleja					X	V	V		
Vasil	Kaleja			V						P
Mihal	Kaleja			V	V					V
						V	V	V		
Menekshe	Kondaj									P
Nihat	Kondaj			V	V					V
Elisabeta	Shehaj									P
Kastriot	Kondaj					V	V	V		
		Mamaj	Kondaj	V	X					
		Artijola	Kondaj	V	X					
		Mariqeni	Kondaj	V						P
		Razip	Kondaj	V						P
		Xhelal	Kondaj	V						P
						V	V	V		
Zagoll	Mustafaraj									P3
Xhemal	Mustafaraj					V	V	V		
		Sultane	Mustafaraj							P2
		Ferdinand	Mustafaraj							P2
		Kujtim	Mustafaraj							P2
Dhuri										P
Shamko	Shehu					Vfot	Vfot	V		
		Adriatika	Shehu	V	X					
		Violeta	Bojaxhi	V	V					
		Egerem	Shehu	V	X					
		Gramos	Shehu	X	X					
		Fitim	Shehu	V	X					
		Aleksander	Bojaxhi	V	V					V
		Arian	Mustafa	V	V					V2
		Sazan	Isiraj	V	V					V3
						V	V	V		
Dhimitra	Jakova			V	V					V
Petro	Leka								ZV	
		Vangjush	Leka							P
Vani	Leka								ZV	
		Yli	Leka							P
		Vladimir	Leka							P
		Irnu	Halo	X	X					





**BOTIMI**

# Shoqëria e Alfabetit

## 120 vite nga themelimi i "Bashkimit"

Fatmira Nikolli

*Del botimi anastatik i "FIALUER i Rii i Shcypës"*


Pas Fjalorit të Frang Bardhit (1635) dhe të K. Kristoforidhit (botuar më 1904) vepra më e rëndësishme e leksikografisë shqiptare deri në mesin e shek. XX, është "FIALUER i Rii i Shcypës". Perbëam Préie Shocniët t'Bashkimit, shtypur në Shkodër më 1908 dhe që njihet shkurt si Fjalori i Bashkimit". Profesor Xhevat Lloshi e përkufizon shumë qartë rëndësinë që ka fjalori i "Bashkimit" i vitit 1908. Më tej profesor Lloshi vëren se parathënia është e 9 janarit 1908, por dihet se punime të kësaj natyre kërkojnë mjaft vite për t'u hartuar dhe sidomos po të mbahet parasysh shkalla e njohjes së leksikut të shqipes në atë kohë dhe e pasqyrimit të tij nëpër fjalorë. Që në programin e Shoqërisë "Bashkimi" parashihej hartimi i një fjalori, krahas punimeve të tjera gjuhësore. Mund të përcaktohet hyrja e shekullit të ri si fillimi i hartimit, pa përjashtuar një vazhde të mëparshme të mblledhjes së fjalës shqipe. Faik Konica më 1904 ("Albania", nr. 2) ka njoftuar, se "Bashkimi po përgatiste një fjalor shqip më të plotë se të gjithë fjalorët e derisotëm". Interesimi i tij shpjegohet me mbështetjen që shprehte për alfabetin e "Bashkimit" dhe me prirjet vetjake për të nxjerrë në dukje fjalët e shqipes. Shoqëria Bashkimi, e themeluar më 1899, krahas fryteve të tjera të punës së saj, mund të quhet edhe Instituti i parë i gjuhës shqipe me një sektor të mirëfillt të leksikografisë dhe me një kartotekë të fjalës shqipe. Nga ajo kartotekë nuk janë marrë të gjitha njësitë, por është bërë përzgjedhja e tyre. Por fjalori është veç një prej punëve që la pas "Bashkimi". Sot në Shkodër pranë Katedrales së Shën Shtjefnit do të përkujtohet 120-vjetori

i Shoqërisë Bashkimi përmes një ekspozite me fotografi të personazheve më në zë të kohës, që qenë pjesë e saj dhe do të përurohet botimi anastatik i tij. Profesor Lloshi vëren në parathënie se me rëndësi të posaçme është, se ky fjalor nuk e ka shënuar prejardhjen krahinore, sepse synimi i tij ishte pasuria e gjuhës shqipe përgjithësisht, siç e ka përcaktuar edhe në titullin e veprës dhe jo vëmendja ndaj prejardhjes krahinore. Për sasinë e fjalëve janë shprehur vlerësimet të ndryshme, të cilat shkojnë nga 10 mijë fjalë deri te 14 mijë. Në numrin e përgjithshëm është njehsuar se zënë vend rreth 1440 huazime nga turqisht-

ja, domethënë rreth 12 për qind. Disa nga recensuesit e kanë quajtur këtë një të metë, duke kërkuar përjashtimin e tyre. Përkundrazi, F. Konica që më 1904 e kishte shtuar si kërkesë, që do të ishte gabim, nëse do të përjashtoheshin të gjitha turqizmat. Vlerën fjalorit ia shton përpjekja për të dhënë togfjalësia, që dëshmojnë përdorimin e fjalës dhe i konkretizojnë kuptimet e saj.

**ZANAFILLA E SHOQNISË "BASHKIMI"**

Në vazhdim e lëvizje politike e kulturore që zhvilloheshin në fundin e shek. XIX brenda dhe jashtë Shqipërisë për unitetin e kombit dhe arsimimit në shqip,



lidhme me shkruar në gjuhën shqipe, seicilli si mbas andjes së vet dhe si mbas prirjet përkatëse". Nga kjo mblledhje e pati zanafillën e vet edhe formimi i shoqërisë "Bashkimi" në Shkodër, e cila në vitin 1899 mori formën e vet zyrtare, me kryetar abat Preng Doçin. Në takimin theme-

lues të Shoqërisë "Bashkimi" ishin: Imzot, Preng Doçi, Imzot Lazer Mjeda, Dom Jak Sarreqi, Atë Gjergj Fishta, Dom Ndoc Sheldia, Dom Gjon Koleci, Dom Mark Shllaku, Atë Pashk Bardhi, Dom Ndoc Nikaj, Dom Dodë Koleci, Dom Mëhill Çuni si dhe laikët Mati Logoreci, Gaper Beltoja, Ndue Paluca

etj. Qëllimi kryesor i kësaj Shoqërie ishte, përhapja sa më shumë e gjuhës shqipe nëpërmjet shtypit të shkruar si dhe shtimi i botimit të librave nga fushat e ndryshme në alfabetin latin, veprime atdhetare, të cilat shërbyen si parapërgatitje për shpalljen e Pavarësisë së vendit tonë në vitin 1912.

ALFABETI E GJUMES MOJPE	ALFABETI E GJUMES MOJPE
A	...
B	...
C	...
D	...
E	...
F	...
G	...
H	...
I	...
J	...
K	...
L	...
M	...
N	...
O	...
P	...
Q	...
R	...
S	...
T	...
V	...
Z	...



duhet veçuar mblledhjen e disa klerikëve të veriut me në krye Dom Ndoc Nikajin, famullitarin e Shkrelit dhe abatin e Mirditës, Preng Doçin, në vitin 1893. Në Shkrel, Malësia e Madhe.

Sipas dëshmitarit të kohës, Dom Ndoc Nikaj, kjo që mblledhje e fshehtë dhe në përfundim të saj, aty u krijua lidhja kombëtare e quajtur "Bashkimi Shqyptar". Nikaj, më tej shprehet se kjo mblledhje: "Kishte për detyrë Bashkimin e Shqyptarve pa dallim feje dhe fisi"... "U



## Dega Fibank Shkodër - e re në çdo aspekt

**21 SHKURT 2019**

Rritja e Fibank dhe veçanërisht zhvillimi i degës në Shkodër çoi në një instalim modern të zyrave të reja, vendosur në qendër të qytetit. Zyra e re ofron një ambient më komod bashkë me një ekip të motivuar dhe të dedikuar për të gjithë klientët e interesuar.

"Fibank është një kompani në rritje dhe ne jemi të angazhuar që të shkojmë më pranë klientëve tanë, kudo që ata ndodhen, duke synuar që të ofrojmë një shërbim të shkëlqyer në funksion të nevojave dhe kërkesave të tyre" - tha drejtori i ri i Degës Shkodër Dritan Meta.

"Për ne është shumë i rëndësishëm besimi që klientët kanë tek banka jonë. Ne kujdesemi që ky besim të reflektohet në çdo aspekt të punës tonë me klientët, por nga ana tjetër jemi të motivuar që të angazhohemi edhe në kuadër të përgjegjësisë sociale për të kontribuar në projekte apo iniciativa në dobi të komunitetit ku shërbejmë" shton ai.

Fibank Albania vazhdon të jetë ndër bankat më dinamike në vend. Me avantazhin e vendimmarrjes tepër të shpejtë, Fibank është shumë aktive në fushën e kredidhënies si për individë ashtu edhe për biznese duke ofruar kushtet më të favorshme, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e klientëve. Staf i dedikuar synon të rrisë bashë e konsumatorëve duke i kushtuar vëmendje të veçantë çdo klienti, duke u shërbyer klientëve të mirë potencialë me shërbime të shkëlqyera dhe produkte shumë cilësore për të arritur një rritje pozitive organike.



# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 649

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Allaj - Art Designer: Nevila Samarxhi  
E shtunë 23 Shkurt 2019

## E LIDHUR ME DJ SARDI? Nevina Shtylla: Shyqyr s'më lidhni me çdo femër që dal në foto



"Luajnë" me mediat si macja me miun, ja të famshmit që pretendohet se janë bashkë

## VALDRIN SAHITI VESH YJET E HUAJ NË 'BRIT AWARDS'



## KUR JETA BËHET E VËSHTIRË, TË FAMSHMIT 'ARRATISEN' NË PUSHIME



## NË SKENË APO NË BURG VIP-at shqiptarë të dënuar së fundmi



- MË E VENDOSUR SE KURRË! NORA ISTREFI NA BËN TË MARRIM SHEMBULL PËR TRUPIN TONË.
- RIKTHEHET SI MË PARË, DAFINA NDRYSHON LUKUN E SAJ DHE DUKET TJETËR NJERI
- ËSHTË NË PRITJE TË ËMBËL, DIELLZA KOLGECI RIKTHEHET SËRISH NË EKRAN!

Nga Rina te Stresi, reperët që nuk mund t'i qëndrojnë larg prangave

# Në skenë apo në burg, VIP-at shqiptarë të dënuar së fundmi

*Pëlqejnë rrezikun apo nuk fitojnë dot lekë pa qenë të jashtëligjshëm?*

Pamela Aliaj

Jetesa në Shqipëri nuk është aspak e lehtë dhe shumë prej nesh zgjedhin një rrugë jo të lehtë dhe të jashtëligjshme për më tepër për t'ia dalë në një jetë më të mirë. Këtë rrugë e zgjedhin jo vetëm njerëzit e thjeshtë, por edhe VIP-at tanë. Jo të gjithë e kanë të lehtë të mbijetojnë në varfëri, por disa prej tyre u pëlqen rreziku dhe preferojnë ta jetojnë adrenalinën në maksimum. Kush merret me narkotikë e kush parapëlqen të marrë gjobë për shpejtësi, e kush thjesht të zihet me 'bandën' e tij, bëjnë që këta VIP-a të njohur në fushën e muzikës të shihen të dënuar apo edhe në pranga. Më poshtë ju listojmë disa prej tyre ku nisim nga ata që s'janë dënuar, por që pëlqejnë rrezikun tek ata që ndodhen akoma prapa hekurave.

## RINA

Që prej momentit kur vendos të bësh gjithçka publike në 'Instagram', madje edhe shkeljet e ligjit, duhet të presësh pasojat. E kemi fjalën për reperen e njohur shqiptare Rina, e cila jo më larg se dje publikoi një video në 'Instagram', ku tregonte se po e ngiste automatjetin pa leje. Rina ka vetëm pak kohë që ka publikuar klipin e ri ndaj dhe në video shfaqej duke kënduar vargjet e këngës së re. Më pas ajo ka pyetur ndjekësit e saj nëse ka ndonjë që udhëton pa leje me makinë: "Të marr me 'Porsh' dhe i nxëmë më shpejt, kush i jep makinës pa leje përveç meje", shkruante Rina. Jo se reperja nuk e di, por thjesht për ta kujtuar po themi që, nëse drejton një automatjetin pa lejen e drejtim-it, në Kosovë gjobitesh në vlerë monetare 500 deri 1500 euro. Këtë gjë ia kanë vënë në dukje reperes edhe ndjekësit në 'Instagram', përmes komenteve të tipit: "Je e vogël për të drejtuar mjetin" apo "Po të shkon rroga duke paguar ligjet që thyen".

## FERO FERA

Fero është një ndër reperat më IN të momentin dhe shumë i preferuar për pub-



likun. Kjo shihet fare mirë në rrjetet sociale dhe klikimet në youtube, mirëpo siç duket tashmë ai ka probleme dhe është dënuar me burg. Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar me 5 muaj burg me kusht dhe 1.200 euro gjobë, pasi aku-

zohet për posedim të lëndëve narkotike. Mirëpo e gjitha kjo e ka një të mirë, pasi gjykatësi vendosi që dënimi me burg ndaj tij të mos ekzekutohet, nëse Fero nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti. Fero, gjithashtu, është i detyruar

të paguajë 1200 euro gjobë. Mesa duket kjo e ka mërzi-tur Arbenitën. Shpresojmë që çifti ta kalojë sa më pare këtë gjendje.

## NOIZY

Telashet e reperit Noizy me policinë nuk kanë të su- sur. Një vit më parë ai u për-

lesh në mes të Prishtinës me Cozman, madje përdorën edhe armët, ndërsa dje raportohet të jetë ndaluar sërish nga policia. Noizy është ndaluar nga policia e Durrësit për kontroll, por kur policët i kanë kërkuar dokumentacionin e mjetit,





cisë. Pasi është ndaluar Noizy është mbajtur për disa orë në komisarit dhe po ndiqet në gjende të lirë për "Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik".

**DEFRI**

Korrikun e 2018, policia italiane ka ndaluar dhe arrestuar në flagrancë 22 persona, pasi akuzohen se janë pjesë e një grupi trafikimi të drogës që vjen nga Holanda. Vihet re që mes të arrestuarve është edhe këngëtari shqiptar Defri, i cili është bërë i njohur për publikun shqiptar pas disa bashkëpunimeve me këngëtares Silva Gunbardhi. Hetimet për këtë operacionin kishin nisur në vitin 2016, ndërsa janë sekuestruar gjatë operacioneve 7 kilogramë kokainë edhe 28000 euro cash. Dëfrim Dervishi, i njohur me emrin e artit si Defri akuzohet për trafik drogrash të rënda, specifikisht kokainë. Prej vitesh këngëtari jeton në Itali dhe duket se aty ushtron-te dhe aktivitetin.

**STRESI**

Reperi i njohur Arkimed Lushaj, i njohur si Stresi është arrestuar në një hotel në zonën e Linzës. Arrestimi i reperit 31-vjeçar vjen pas një hetimi disa mujor me metoda speciale ndaj një grupi kriminal që operonte në kryeqytet, pjesë e të cilës dyshohet se është edhe Stresi. 'Forca e Ligjit' në veprim vë në pranga një nga anëtarët e një grupi kriminal që operon në Tiranë në lidhje me aktivitetin e kundërligjshëm me tendencë 'Trafikim narkotikësh' dhe 'Krimet kundër personit'. Gjatë kontrolleve të ushtruara në dhomën e hotelit ku ndodhej Stresi është gjetur dhe sekuestruar një sasi e vogël kokaine, një armë zjarri pistoletë e tipit "Pietro Beretta" si dhe 12 fishekë të modelit 7.65 mm. Bashkë me reperin, policia e Tiranës ka shoqëruar në Komisaratin nr.4 edhe një 20-vjeçare nga Tirana me iniciale P. Ç. Vajza do të procedohet në gjendje të lirë për veprën penale të 'Moskallimit të kimit'. Por kjo nuk është hera e parë që Arkimed Lushaj prangoset për mbajtje armësh pa leje, ai njihet edhe për përfshirjen e tij në sherre dhe konflikte të tjera. Herën e fundit, Stresi ka përfunduar në prangat e policisë, ka qenë në 13 prill të këtij viti, teksa konsumonte kokainë në një lokal në Tiranë. Ndërkaq, ai është arrestuar edhe disa herë të tjera, pasi qarkullonte me armë pa leje. Madje në disa raste reperi shqiptar i ka publikuar vetë foto me armë në rrjetet sociale.



rezultoi se nuk kishte leje drejtimi me vete dhe një mal me gjoba të papaguara. Të ndodhur para këtij fakti rrugorët e Durrësit kanë dashur ta shoqërojnë në polici, (deri në momentin që ndonjë person të sillte lejen e tij të drejtimit dhe të

paguante gjobat), por këngëtari nuk iu është bindur dhe është larguar me shpejtësi. Arratia i ka zgjatur deri në patrullën e radhës, të cilët ishin sinjalizuar për një automjet tip Benz me targa AA 517 MT që i kishte shpëtuar poli-

## Është në pritje të ëmbël, Diellza Kolgeci rikthehet sërish në ekran!



**E**dhe pse së fundmi është në një pritje të ëmbël, bukuroshja Diellza Kolgeci do të rikthehet shumë shpejt në ekran. Lajmin e ka dhënë Olti Curri, i ftuar dje në emisionin e Rudina Magjistarit. Bukuroshja shqiptare ka në plan t'i rikthehet ekranit shumë shpejt, pas lindjes së fëmijës së saj të parë. Pak ditë më parë Diellza zbuloi edhe gjininë e fëmijës që po pret në një festë "BabyShower", në të cilën u mësuua se është në pritje të një vogëlusheje me partnerin e saj Fisnik Rugova. Dje Olti Curri tregoi edhe një detaj të ri për bebushin që do të vijë në jetë shumë shpejt. Diellza ka shtuar 13 kg gjatë shtatzënisë, por fakti që është elegante dhe e gjatë e bëjnë të mos e tregojë shumë shtimin në peshë. Partneri i Diellzës është basketbollist dhe është 11 vite më i ri se ajo. Burime pranë çiftit kanë treguar se Diellza dhe basketbollisti njihen prej shumë vitesh duke qenë se të dy jetojnë në Prishtinë, megjithatë lidhja e tyre e dashurisë ka nisur vetëm një vit më parë.



Partnerë në punë e jo në jetë? VIP-at që s'po kapen mat

# E lidhur me Dj Sardi? Nevina Shtylla: Shyqyr s'më bëni të lidhur dhe me çdo femër që dal në foto

*“Luajnë” me mediat si macja me miun, ja të famshmit që pretendohet se janë bashkë “A jemi a s’jemi” një? Nga Flori me Fifi te Nevina me Dj Sardin, artistët e pashpallur çift*

Pamela Aliaj

Edhe pse janë duke bërë çmos të fshehin jetën private, mesa duket VIP-at tanë kanë vendosur të kalojnë nga ana tjetër e të ‘luajnë’ me mediat rozë. Kjo vihet re qartë nga postimet e tyre të herë pas herë në mediat sociale me të ashtuquajtur ‘miq’ të tyre. Pra, duke qenë se vetëm për një foto të dalë bashkë apo një zemër të postuar në Instagram, ngrihen dyshimet mes dy VIP-ave të njohur dhe duke qenë se janë bërë të gjithë dyshues dhe ekspertë, VIP-at tanë vendosën që të dalin ‘hapur’ në marrëdhëniet që kanë me njëri-tjetrin. Por kjo e dalë ‘hapur’ shihet si e dyshimtë nga ana e atyre që e lexojnë, sepse nuk ka mjaftueshëm siguri në ata që vetë të famshmit tanë vendosin të nxjerrin. Duke qenë se mjafton pak ‘thashethem’ për t’i hedhur benzinë zjarrit e për t’i shpërndarë në të gjitha portalet, pse jo mos të përfitojnë që në këtë mënyrë ose të promovohen në këngë apo projekte, ose të fshehin atë që vërtetë ata mund ta kenë një lidhje. Më poshtë shohim disa prej atyre që e bëjnë më pak të besueshme ‘lidhjen’ mes tyre me daljen hapur në rrjetet sociale:



## FLOR MUMAJESI ME FIFI APO KEJSI TOLEN?

Prej kohësh mediat rozë janë në ‘përgjim’ të dy këngëtarëve. Fifi dhe Flori Mumajesi kanë patur disa episode në media të postuara që kanë bërë që dyshohet se mes tyre kishte më tepër se shoqëri. Ndërkaq para dy ditësh vetë këngëtarja Fifi vendosi t’i surprizojë të gjithë dhe të postojë në ‘Instagram’ një njoftim, ku i tregon të gjithëve se do të fejojë. “Ej

njerëz, po fejojem, ose me 3 ose me 9”- shkruan Fifi në Insta-story, duke e shoqëruar shpalljen e fejesës dhe me një emoji, i cili tregon entuziazmin e saj për këtë ngjarje të rëndësishme. Gjithsesi ne kemi shumë pyetje... Bëhet fjalë për 3 dhe 8 mars? Me kë do të fejohet? Kur e mori këtë vendim? Dhe mbi të gjitha, pse është midis datës 3 dhe 8? Gjithashtu, ka mundësi që ky njoftim të jetë pjesë e strategjisë për të njoftuar







projektin e saj të ardhshëm muzikor. Siç mund të jetë dhe kjo foto e postuar para kësaj story: Që është shumë e ngjashme me këtë foto të postuar nga Flori Mumajesi. Gjithashtu, ajo postoi dhe një video të shkurtër që e fshiu shumë shpejt, nga ky është shkëputur kjo foto: Pra, fejesa mesa duket ishte projekt muzikor. U zbulua se ky projekt i bërë mes të dyve do të publikohet në datat 8 ose 10 mars, ndërkohë që kanë bërë gati dhe video-klipin. Por përveç kësaj disa postime të mëparshme të vendosura në pah nga fansat e të dyve tregojnë se dy këngëtarët kanë të njëjtat shije në veshje dhe janë parë shpesh në foto me atlete apo bluze të njëjta. Të jetë ky një lloj sinjali që tregon lidhjen mes të dyve? Ndërkaq kujtojmë nga ana tjetër se në shumë postime të mëparshme Flori u diskutua për një lidhje me këngëtarën Kejsi Tola. Pra, vendos Flori: Kejsin apo Fifin??

**DJ SARDI ME NEVINA SHTYLLËN APO JONIDA VOKSHIN?**

Pas ndarjes nga balerina Jori Hodo, ai mbetet një nga 'beqarët' më simpatik në vendin tonë. I referohemi për DJ Sardi, i cili së fundmi na ka tërhequr vëmendjen me postimet e tij. Në fillim u përfol se kishte një lidhje me moderatoren Jonida Vokshi e tani së fundmi dyshohet që të ketë diçka me moderatoren bukuroshe Nevina Shtylla. Mendohet se dy të rinjtë janë çifti me i ri i showbizit. Kjo ka bërë të dyshohet nga një foto që ka qenë vetë Sardi ai që e ka publikuar në 'Instagram'. Ndërkaq miqtë e të dyve pohojnë se shpesh të rinjtë kalojnë kohë në shoqërinë e njëri-tjetrit e jo thjesht si dy miq. "Drita" ka shkruaj Sardi duke iu referuar Nevinës. Ndërkohë që

pak më parë lajmi se mes moderatores simpatike Jonida Vokshi dhe DJ Sardi, ka më shumë se shoqëri, ka bërë bujë në media. Ndonëse asnjëri prej tyre nuk e konfirmoi, dyshimet mediatike dhe të fansave vetëm sa shtohen. I ftuar tek emisioni 'Familja' gjatë mbrëmjes së djeshme, Sardi ka lënë të kuptohet se mes tyre ekziston diçka. I pyetur nga Turjan Hyska nëse ishte e vërtetë që është në një lidhje me të, DJ është përgjigjur me një fjalë të vetme, duke lënë të kuptohet një përgjigje pozitive. 'Mbase', tha i buzëqeshur Sardi.

**NDËRKOHË PËR BLUETOOTH TË GAZETA SHQIPTARE KA REAGUAR**

**Nevina Shtylla:** Shyqyr s'më bëni të lidhur dhe me çdo femër që dal në foto. Se me meshkujt ia morët dorën, quhet e mireqenë!

**ARBANA OSMANI ME EDUART GRISHAJ?**

Kjo është një ndër historitë më të komentuara të momentit në shtypin rozë. Në fakt, të tillë e bëjnë vetë protagonistët e saj. Prej disa ditësh, në media po përfillet një lidhje e re dashurie mes moderatores Arbana Osmani dhe regjisorit të "Dua të të bëj të lumtur", Eduart Grishaj. Ndonëse, Arbana nuk ka reaguar personalisht pas lajmeve në shtypin rozë, duket se faktet janë më kokëforte se kaq! Ajo i ka dhënë fund lidhjes 16-vjeçare me Ardit Keron, me të cilin ka edhe një djalë, Jon. Me gjithë vendimin personal për të mos u shprehur publikisht përmes intervistave apo deklaratave të ndryshme, janë miqtë e tyre të afërt ata që flasin dhe komentojnë lidhjen më të re të dashurisë brenda Top Channel, mes Arbana Osmanit dhe regjisorit të "Dua të të bëj të lumtur" Eduart Grishaj. Por, veçmas anës mediatike, duhet fare pak vëmendje dhe kujdes për të kuptuar përmes postimeve të tyre në rrjetet sociale, se komentet, fotot e përbashkëta, udhëtimet e shpeshta brenda dhe jashtë vendit janë provë e gjallë e kësaj romance të re. Por pavarësisht këtij lloj afrimiteti kaq hapur në rrjetet sociale, duhet më tepër për të qenë të sigurtë se mes tyre ka diçka më tepër se shoqëri shumë e mirë. Duke qenë se vetë Arbana ka qenë shumë diskrete për jetën private, postime të tilla kaq hapur na vënë në dyshim për diçka më tepër mes të dyve. Gjithsesi mbetet për t'u parë!





Kush në Bora-Bora e kush në Alpet zvicerane, ja destinacionet e të famshmëve këtë muaj

# Kur jeta bëhet e vështirë, VIP-at 'arratisen' në pushime

*Nga Ana Lika te Luana Vjollca, artistët që preferojnë të udhëtojnë më shpesh*

Pamela Aliaj

**E**dhe pse të gjithë ne jemi të zhytur në punët e në përditshmërinë tonë, ardhja e fundjavës është ajo që na qetëson më tepër dhe na ngushëllon herë pas here për të na hequr edhe lodhjen e gjithë javës. Por ka të tjerë që kanë luksin të shijojnë më tepër sesa vetëm një fundjavë larg stresit e punës. Janë pikërisht VIP-at tanë të cilët pas përfundimit të një sezoni të gjerë të punës, arrijnë të 'arratisen' në destinacionet e tyre të preferuara. Së fundmi kemi vënë re se shpesh e kanë edhe si terapi për t'u rikthyer me energji të reja dhe më në formë se kurrë. Në listën tonë nuk përfshijmë vetëm moderatorin Luana Vjollca, por edhe shumë VIP-a të tjerë, të cilët udhëtojnë para ardhjes së pranverës dhe besojmë se me të dhe të sezoneve të reja, të 'zhduken' në destinacione larg Shqipërisë. Më poshtë ju listojmë disa prej tyre:

## LUANA VJOLLCA

Moderatorja e njohur, Luana Vjollca, e cila pas përfundimit të emisionit "Shiko Kush Luan", lançimit të këngës më të fundit dhe hapjes së faqes së saj me veshje që mbajnë emrin e saj, vendosi t'i dedikohet 100% vetes dhe të dashurit të saj (ende të pakonfirmuar), Krenar Cocaj. Çifti vendosi të zgjidhte një nga destinacionet më të preferuara të momentit për të risjellë më herët shijen e verës, Bora-Bora. Por para këtij udhëtimit ajo vendosi të bënte një tjetër me familjen. Së bashku me dy motrat e saj më të mëdha, Marinën dhe Lirën, shkuan të shijonin ditët e fundit të dimrit duke bërë ski në Austri.

## ANA LIKA




Herë pas here, aktorja e njohur Ana Lika preferon të marrë avionin e të udhëtojë jashtë vendit. Nuk mund të themi se ka përfunduar sezonin e punës, ku aktualisht ndodhet, përveç teatrit, tek emisioni "Mos i fol shoferit" i Rudina Dembacaj. Por një udhëtim në Belgjikë, mbase edhe vetëm për fundjavë e ka bërë atë të largohet nga zhurma e Tiranës. Ka qenë vetë Ana ajo që ka postuar në 'Instagram' jo vetëm biletën e avionit, por, gjithashtu, dhe pamje nga vendi ku ajo do të rrijë në Belgjikë.

## MARINA VJOLLCA

Marina Vjollca ka postuar një seri fotosh derisa është duke i kaluar pushimet dimërore në Austri. Marina bashkë me motrat e saj, por edhe me të shoqin e saj, Getoar Selimi është duke i kaluar pushimet dimërore në resortin turistik të Kitbuhel të Austrisë. Por prezantuesja e njohur shqiptare edhe pse në dimër ka treguar disa nga linjat e saj seksi.

## ALKETA VEJSIU

Alketa njihet për dëshirat e saj të mëdha për të udhëtuar në shumë vende të botës. Duke qenë se janë ditët e fundit të dimrit, ajo nuk harron t'i shfrytëzojë ato në një vend fantastik të mbuluar me dëborë. Duke qenë se është tepër aktive në 'Instagram', ajo edhe në ditët e pushimit nuk harron të postojë pamje nga vendi mrekullueshëm ku po relaksohet. "Duke shijuar ditët e fundit me dëborë", shkruan Alketa. Dhe vërtet nga pamja duket se është duke kaluar momente të veçanta në një kompleks luksoz në mes të dëborës.





## Mbajti dietën e Jennifer Lopez, Iva Tiço rrëfen “vuajtjet”: Për 10 ditë humba 2 kg

Iva Tiço, gazetaria e njohur shqiptare, ka rrëfyer vështirësitë e dietës së famshme që ka mbajtur këngëtarja Jennifer Lopez. Iva Tiço e ndoqi dietën strikte 10 ditore dhe premtoi se do të ndante momente hap pas hapi në profilin e saj në 'Instagram'. Por ditën e djeshme, tek "Rudina", Iva u shpreh se nëse nuk do të kishte premtuar në emision, ajo do të kishte hequr dorë shumë shpejt, pasi të linte sheqernat ishte shumë e vështirë për të. Iva tha se në 10 ditë humbi 2 kg dhe na bëri të kuptojmë se po të mos kishte qenë për faktin që u bë publike, do ta kishte shkëlur dietën, e cila sipas saj ishte më e vështirë sesa të lije cigaren. "Kuptova që kisha varësi nga sheqernat. E pata më të vështirë sesa shoqja ime që po linte cigaren", u shpreh ajo duke na treguar vështirësitë e kësaj diete. Për gjithë ata që janë kuriozë të dinë, dieta 10-ditore e Jennifer Lopez kërkon ushqimin me produkte pa sheqerna, yndyra, pa brumëra por vetëm me ushqime të shëndetshme që përmbajnë proteina.



## Më e vendosur se kurrë! Nora Istrefi na bën të marrim shembull për trupin tonë

Nora tregon ushtrimet që kryen për tu dukur gjithnjë në top formë. Këngëtarja e mirënjohur, Nora Istrefi është njëra ndër femrat më të pëlqyera dhe të komentuar të showbizit. Nora, e cila po vazhdon t'i ruaj përmasat ideale trupore, në rrjetin social 'Instagram', ku numëron mbi 800 mijë ndjekës, ka publikuar një video ku shihet duke ushtruar në palestër.

## Rikthehet si më parë, Dafina ndryshon lukun e saj dhe duket tjetër njeri

E mban mend njeri Dafina Zeqirin me flokë të gjatë? Mesa duket edhe vetë këngëtarja është ndjerë nostalgjike përdërisa ka ndryshuar look këtë fundjavë. Dafina ka publikuar një foto në 'Instastory' ku shfaqet me flokët e gjatë të zinj dhe me baluke dhe na duhet të themi se duket tjetër njeri. Kjo besojmë se do të jetë paraqitja e këngëtares në mbrëmjen e djeshme, në koncertin që ajo do të mbajë në qytetin e Shkodrës. Pas suksesit me këngën "Alo" në bashkëpunim me DJ Geek, Dafina po zhvillon një tur koncertesh në Shqipëri dhe pas Shkodrës ajo ka premtuar të mbledhë edhe fansat e Tiranës.



## Shkëlqen me veprat e tij, Valdrin Sahiti vesh VIP-at e huaj në 'BRIT Awards'

Padyshim që Valdrini Sahiti është një emër i njohur në fushën e modës në Shqipëri dhe Kosovë, por jo vetëm. Prej kohësh ai vesh personazhe të njohur brenda dhe jashtë Shqipërisë. Veshjet e tij kërkojnë edhe nga klientë që jetojnë jashtë trevave shqiptare, që kanë parë online stilimet e tij. Këtë herë një lajm shumë i bukur vjen nga Britania, ku vetëm dy ditë më parë u mbajt 'BRITs Awards'. Mbase nuk e keni vënë re, por dy nga këngëtares e grupit 'Little Mix' janë veshur nga stilisti Valdrin Sahiti. Bëhet fjalë për Jade Thirlwall dhe Jesy Nelson, të cilat u cilësuan nga mediat më të njohura në botë, si të veshurat më bukur. Edhe njëherë tjetër, një emër shqiptar ka kaluar kufijtë me originalitetin dhe idetë e veçanta.

Opinion *i* Ditës

# Kontrata e prishur dhe gjumi i prishur

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

...ndodhur në këto 28 vite pluralizëm. Dhe jo vetëm tek ne. Një dorëheqje kolektive nga detyra e përfaqësimit të qytetarëve nuk është parë në asnjë vend të Evropës në gati më shumë se një shekull. Përbën mirëfilli një veprim të panjohur më parë. Ndaj një dorëheqjeje të tillë kolektive nuk mund dhe nuk duhet të kryhet asnjë sulm. Shumica qeverisëse po bën gabim fatal duke sulmuar opozitën e porsaflijuar. Kur duhet të fillojë të reflektojë. Mjafton të pickojë veten dhe të përfytyrojë si do t'i duket vetë kësaj pozite, vetë anëtarëve të kabinetit qeveritar salla e parlamentit të enjten. Është ndryshe kur ke një bojkot dhe e di që është i përkohshëm dhe që një ditë opozita të kthehet. Kurse një parlament pa opozitën në një vend demokratik nuk është më i tillë. Nuk është më panteoni i vendimmarrjes qytetare. Kjo, pasi nuk përfaqëson të gjithë popullin. Parlamenti shqiptar këtë të enjte nuk do të përfaqësojë të gjithë qytetarët e këtij vendi. Dhe kjo është e rëndë, shumë e rëndë. Këtë të enjte dhe të gjitha të enjteve që vijnë do t'i mungojnë përfaqësuesit e 675 mijë qytetarëve. Kjo është si të të lëvizin themelet. Reflektimi i parë që vjen janë fjalët e disa protestuesve të 21 shkurtit përpara Kuvendit, të marra nga një televizion. "Protestoj për tatimet që janë rritur, për pensionet e vogla, për papunësinë", thotë një qytetar. "Vetëm se s'kam ku të shkoj, se nga sytë këmbët iki për një sekondë nga ky vend", shprehet një tjetër. "Pa punë, pa asgjë. Të paktën më parë kemi punuar në të zezë. Por tani as në të zezë dhe as në të bardhë". Këto janë fjalë që duhet t'i hynë qeverisë sonë në zemër dhe të tronditet. Të tronditet për taksat që ka zbatuar deri tani. Për investimet qindra milionë euroshe në pesë vite e gjysmë që nuk kanë pjellë vende të reja pune. Për dritat që të varfrit i paguajnë deri më një sot (shumë mirë), por që ky shpenzim i rritur në buxhetin e tyre u duhej kompensuar urgjen-



tisht jo me një 5 mijë lekësh të vjetër tallës në muaj, por me shanse reale pune. Për punën në të zeze që është më e pakët sot (shumë mirë), por që ky pakësim të mos linte të dëshpëruar ata që thonë "më mirë në të zezë dhe në punë, se sa në të bardhë dhe pa punë!". Këtë realitet duhet të shohë qartë qeveria jonë sot. Të mos fshihet pas pëllëmbës së vet, sado e madhe t'i duket ajo. Dhe ky nuk është realiteti virtual i televizionit qeveritar. Këta nuk janë ata të paktë qindra qytetarë, hallet e të cilëve kanë gjetur zgjidhje nga bashkëqeverisja. Këta protestues të 21 shkurtit mund të jenë edhe ndjekës të një partie politike, por në radhë të parë janë qytetarë të këtij vendi me problemet dhe hallet e tyre. Të pagzjidhura! Në rrugë i nxjerr një makth për të ardhmen dhe i shtyn një protestë e natyrshme. Një zhgënjim i madh. Qeveria duhet ta shohë këtë zhgënjim. Deri tani ka parë një opozitë sipas kararit të saj. Të kompleksuar nga gabimet dhe fajet kur ishte në pushtet. Të papërtërirë, të gozdhuar tek figurat e së kaluarës. Me mungesë idesh dhe fryme konstruktive. Që vrapon pas diskutimesh-hartime në Kuvend, që i gëzohet batutës së bukur "demaskuese", që s'ka kohë të lexojë auditimet-dënonime të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por mëson(edhe ato gabim) disa shifra përmendësh. Është ndjerë mirë dhe rehat kjo pozitë, kjo qeveri e sotmja, me këtë opozitë kaq komode për të. Që me skeletet që fsheh në dollapët opozitarë(të mbushura me dosje të frikshme të abuzimeve të periudhës në pushtet), ia bën qeverisjen kaq të lehtë dhe të qetë(edhe pse përpara kamerave në foltoret e Kuvendit, kaq të zhurmshme). Si dhe mundësinë e fitores në qershor 2021 kaq të qartë. Por tani kjo lojë nuk po luhet më. Dhe qeveria duhet të fillojë ta ketë gjumin e prishur. Njëlloj si kontrata që deputetët e opozitës, duke u dorëhequr nga detyra për përfaqësim, prishën me 675 mijë qytetarë shqiptarë më 21 shkurt. Faji i tyre? I këtyre deputetëve kaq të papërgjegjshëm? Që i merrrohen vetingut, që i zë ankthi dhe makthi natën nga perspektiva e hekurave të burgut? Sigurisht që është edhe faji i tyre. Por jo vetëm i tyre, ama! Psherëtimat dhe ankesat e qytetarëve të thjeshtë, të intervistuar në protestën e 21 shkurtit, e dëshmuar këtë. Prandaj dhe kësaj qeverisë tonë sot duhet të fillojë rëndshëm dhe fort t'i prishet gjumi natën. Ndryshe nuk ka të ardhme të sigurte ajo dhe vetë vendi ynë.

BLUE TOOTH

THASHETHEME  
MADE IN  
ALBANIA

V

te rejat  
nga jeta  
ipave

çdo të shtunë falas me



Opinioni *i* Ditës

# Edhe njëherë për domosdoshmërinë e "dhunës"

Nga Andë Bushati

(vijon nga faqja 1)

...dhe studiove televizive po vërtitet rreth "dhunës". Qeveria, kryetari i Kuvendit, policia, Garda, ambasadat e huaja njëra pas tjetrës, Brukseli dhe Uashingtoni po denoncojnë gjëmën që kujtojnë se ngjau dhe njësoj si Nastradini, po shpërndajnë ndëshkime edhe për atë që do të ndodhë në të ardhmen.

E zënë në çark, në këtë vorbull propagande, edhe opozita, që kreu aktin e saj më radikal në këto 30 vite duke djegur mandatet, është kapluar nga kompleksi i dënimit të akteve ekstraligjore. Shprehja e përfaqësueseve të saj i ngjan më shumë sjelljes së fajtorëve pa faj. Ata i dënojnë militantët e vet që kryen krime të barazvlefshme me mosecjen mbi vijat e bardha apo shkeljen e semaforëve, duke u justifikuar me alibinë: "Gjithçka e bëri zemërimi i popullit, i cili nuk pyet më as për ne".

Në fakt, kjo është një gënjeshtëri, sa e pabesueshme, po aq edhe e panevojshme. Nuk ka shqiptar që nuk e di se ato pak akte force që u bënë të shtunën e 16 shkurtit, ishin frymëzuar, planifikuar dhe nxitur nga PD-LSI.

Por, debati nuk është ky. Pyetja që shtrohet nuk është nëse e ushtroni opozita, atë që për lehtësi komunikimi të gjithë kemi rënë dakord ta konsiderojmë si "dhunë", por e rëndësishme është diçka tjetër: a qe e domosdoshme ajo, madje edhe akte shumë më ekstreme?

Përgjigja më e thjeshtë për këtë na vjen nga një demokraci shumë më e lashtë dhe e përpaur se ne, nga një vend që u ka prerë kokat e mbretërve dy shekuj më parë, pra nga Franca, e cila u përball me një krizë shumë më të fortë demokracie, me protestën mbi tremujore të "jelekëve të verdhë". Ato që ndodhën çdo fundjavë në avenue des Champs-Élysées mund të konsideroheshin vërtet akte dhune, pa përdorur thonjëzat që ne vëmë për të përshkruar atë që ngjau në Tiranë. Djegia dhe thyerja e dyqaneve, shkatërrimi i pronës private, bllokimi i autostradave, thyerja e statujave që gjendeshin brenda "Harkut të Triumfit", qenë imazhet më të forta të asaj zemërate.

Dhe po të dëgjoje ata që e mbështesnin lëvizjen e "gilets jaunes", avokatia e tyre ishte unanime: "Nuk ka mënyrë tjetër veç akteve të dhunës, për të bërë të dëgjohet zëri i atyre që shpërfillen. Nuk ka mjet tjetër për ta bërë pushtetin dhe kastën të mbajë vesh".

Natyrisht, njihet edhe kundërgjegjësia e atyre që qëmojnë diferencën mes asaj që ndodhi në atdheun e galëve dhe kësaj që ka marrë jetë në vendin e shqiponjave. Ata thonë se nuk ka ng-



jashmëri, sepse në Francë u ngrit një pjesë e popullit, ato grupime të marginalizuara dhe rurale që nuk gjendeshin fare të përfaqësuara dhe ndiheshin të padëgjues nga sferat e larta, ndërsa në Shqipëri po proteston opozita, e cila kishte gati gjysmën e parlamentit, e cila ka vëmendjen mediatike, e cila është prezente kudo, pra që nuk mund të ankohet për shpërfillje dhe mosdëgjim.

Dhe këtu vijmë në pikën kyçe. Po, a mund të konsiderojë çdo individ i arsyeshëm dhe me gjykim të lirë se opozita është e përfillur dhe e dëgjuar në Shqipëri?

A mund të quhet ajo e tillë, kur edhe pasi zbulon një vjedhje 40-milionëshe, askush nuk përfundon në burg?

A mund të quhet ajo e tillë, kur edhe pasi provohen vjedhjet e zgjedhjeve në bashkëpunim me bandat e drogës, askush nuk ndëshkohet?

A mund të quhet ajo e tillë, kur qeveria fal koncesione dhe PPP që e tejkalojnë në pesëfish mandatin e saj kohor?

A mund të quhet ajo e tillë, kur

parlamenti miraton ligje antikush-tetuese "ad nominem" dhe askush nuk ka gjykatë ku të ankohet?

Të gjitha sa më sipër tregojnë se, njësoj si kudo, nga Parisi në Karakas, aktet ekstraligjore të forcës nuk janë asgjë më shumë se klithma për t'u dëgjuar dhe për të tërhequr vëmendjen.

Madje, shpeshherë ato shërbejnë si katalizatorë për transformime të mëdha.

Nuk dua të përmend këtu një argument që e kam stërpërdorur, atë për vitin e 1997. Atëherë dhuna tragjike, madje rrëmbimi i armëve, prodhoi një Shqipëri më të mirë. Ajo shërbeu për shembjen e regjimit diktatorial të Berishës dhe sado e rëndë që ishte kostoja njerëzore, ajo na la trashëgim një vend ku morën fund burgosjet politike të kundërshtarëve, ku Sudja dhe Xhaferri u zëvendësuan me banka private, ku megafoni i vetëm i pushtetit, ekrani shtetëror, u mposht nga dhjetëra televizione të reja që lindën si pasojë e erës së re të lirisë.

Pra edhe tani, në situatën ku gjendemi, askush nuk mund ta mohojë se përdorimi i mjeteve ek-

straligjore është shpresë për ditë më të mira të nesërmen.

Duke qenë një nga ata që besojnë se është dhunë më e madhe të shembësh për interesa okulte 300 shtëpi të mjerësh tek Unaza, sesa të thyesh kërpudhën; se është më ekstreme të rrëmbesh tokën publike në qendër të Tiranës dhe të ndërtohet gjashtë kulla 200 milionëshe, sesa të zaptosh me forcë sallën COD të Kryeministrit; se është më kriminale të blesh vota me Avdulajt, sesa që protestuesit të hyjnë me forcë në mjediset e parlamentit; unë i shoh të dytat si të vetmen rrugë për të neutralizuar të parat.

Sepse të gjitha këto veprime të "dhunshme" nuk janë asgjë tjetër veçse apel që shqiptarët të hapin veshët dhe ndërkombëtarët të kthejnë sytë nga ato krime që propaganda e regjimit po i mban të relativizuara. Dhe historia na mëson se sa më ekstreme të jenë këto akte, aq më e madhe do të jetë vëmendja për të dekurruar mëkatet e Rilindjes. Pra, sa më shumë të shtojmë "dhunën", aq më pranë do të kemi zgjidhjen.

"Lapsi.al"

## HOROSKOPI



DASHI

Të qënurit diplomatik është gjë e mirë, por të qënit në kontroll të gjërave është më efektive. Të jesh një lojtar i ekipit nuk do të thotë që duhet të sakrifiko-sh inteligjencën tënde dhe të menduarit kritik. Vetëbesimi tuaj do të shërbeh mirë në qoftë se ju e thoni hapur mendimin tuaj.



DEMI

Sot mund të shfaqeni si një superhero në sytë e një miku. Kjo për shkak se ndihma që do t'i jepni, do të jetë në momentin që ai ke më shumë nevojë. Mos e kurseni ndihmën, sepse ajo të kthehet në mirësi për ju.



BINJAKET

Ka shumë energji përreth jush dhe nëse nuk e trajtoni si duhet, mund të digjeni. Përdoreni fatin për të realizuar ndonjë projekt që ju ka ngelur peng. Ju keni diçka të vlefshme për të ofruar dhe njerëzit kanë nevojë për praninë tuaj sot.



GAFORJA

Angazhohuni më shumë në komunitetin që ju rrethon sot. Lidhje të puditshme mund të lulëzojnë papritur dhe nëse e bëni të qartë se jeni i arritshëm dhe miqësor, do të keni shansin të arrini një synim të ri.



LUANI

Për të mos u përballur me disfata, duhet të mbani veshët dhe sytë hapur. Qëndroni vigjilentë për gjithçka që ndodh rreth jush dhe mbajini nën vëmendje njerëzit që i mbajni dyert e mbyllura ndaj jush. Bëhuni gat për të marrë një propozim lakmues dhe përgjegjësi të reja.



VIRJERESHA

Ndonjëherë, kur mendja juaj është mbërthyer në të shkuarën ose futuron shpejt përpara në të ardhmen, ju humbin të gjitha gjërat e mrekullueshme që janë para jush. Dikush dëshiron të bëjë një lidhje më të thellë me ju, por ende nuk po e merr vëmendjen tuaj.



PESHORJA

Ju duhet të ndërtoni një urë sot mes të kaluarës së lumtur që keni pasur me dikë dhe të ardhmen e lumtur që shpresoni të keni. Përgendrohuni në pjesët e mira të asaj që ju të dy keni tani dhe do të jeni sënish të lumtur.



AKREPI

Nëse jeni në një marrëdhënie romantike, ju mund të prisni që gjatë të zhvendosen në mënyrë në mënyrë të shpejtë. Kjo mund të jetë faza e re e rritjes që po shpresoni. Është koha që të jeni më reflektues në atë që dëshironi nga jeta.



SHIGJETARI

Nuk ka asgjë më të fuqishme se të dish gjithçka që duhet të dish dhe të kesh gjithë energjinë që duhet për ta përdorur atë rihori në avantazhin tënd! Duke kapërcyer disa formalitete, do të arrini në thelbin e disa çështjeve të rëndësishme.



BRICJAPI

Nëse ndiheni në errësirë rreth një projekti aktual, tërhiquni dhe analizoni nga një perspektivë e re. Në këtë mënyrë do të arrini të jeni më i qartë dhe të përmbleni me sukses planin tuaj. Vjet ju favorizojnë në aspektin financiar.



UJORI

Është koha që ju të zotëroni artin e shijimit të jetës. Gjoni diçka që ju pëlqen të bëni. Gëzojuni çdo moment të përvojës dhe do të jeni i ndrohur të reja se si mund ta përmirësoni atë. Imagjinoni përvojat më të kënaqshme që mund të bëni dhe do të jeni një hap më afër për t'i realizuar ato.



PESHQI

Nëse dëshironi të jeni pjesë e jetës së dikujt, duhet të tregoheni i vendosur. Gëllitni kërenë tuaj dhe bëni atë që duhet në dëshirë. Shprehuni hapur rreth asaj që ndjeni dhe do të dilni i vlerësuar.

Trajneri i Tiranës nuk e fsheh gëzimin

Mema: Lotët? Jemi bërë pak qaramanë! Të fitojmë derbin

Trajneri i Tiranës, Ardian Mema, ka qenë mjaft i emocionuar pas golit të shënuar nga Majkëll Ngo, teksa nuk i ka mbajtur dot lotët e gëzimit. Pas ndeshjes, tekniku bardheblu është shprehur për "Super-sport" se kjo fitore vlen shumë sidomos sepse në prag është derbi ndaj Partizanit, ndërsa ka rrëfyer dhe momentin e tij të gëzimit.

**A jeni i kënaqur?**  
Më gëzoi shumë fitorja, sidomos pikët na duheshin shumë. Treguam që kemi forcë të mundim një ekip si Skënderbeu.

**Keni gjetur perfektën me ekipin tuaj?**

Një trajner do kohën e vet, ekipi ka ardhur duke e rritur lojën. Gjithsesi kishim dhe sot oshilacione. Nuk kisha shpresa dhe nuk e prisja të fitoja sot me këtë paraqitje. Skënderbeu na toleroi disi në fazën mbrojtës ndaj

gjetëm golin e fitores në fund.

**Mbrojtja gaboi**

I gjithë ekipi ka shumë probleme. Pasi ne kemi ardhur nga vendet e fundit. Janë riparuar disa repartet dhe ekipi shprehet gjatë lojës, por ka ende probleme.

**A ishte e njëjta taktikë si me Kukësin?**

Pak a shumë ishte e njëjta tablo, por e pritëm në mes-fushë dhe jo në mbrojtje. Kemi pasur dhe dy mundësi për shënim dhe nuk u shënuam. Ky është futboli, jo çdo manovër na del.

**Çfarë do të bëni nëse fitoni derbin javën tjetër?**

Lotët? Ka qenë një moment në gëzim e sipër. U emocionova shumë pasi isha dhe pjesë e Skënderbeut. Jemi bërë disi qaramanë (qesh). Kam qarë shumë duke humbur ndaj qesh kur

fitoj.  
**Pse nuk synon sulmin, kur e ke pikën e fortë?**

Ne kemi sulmuar, por kemi dhe momente paniku. Ky është sugjerim i drejtë, pasi kemi shumë sulm të fortë në krahasim me repartet e tjera. Dua të luajë në grup dhe jo t'i besoj një reparti.

**A keni një dedikim për këtë fitore?**

Jo, nuk kam. Tifozët i përsëhënd dhe shpresoj që kjo fitore të na ndihmojë në derbi.

Në Korçë, Skënderbeu-Tirana mbyllet 2-1. Ngo shënoi golin e fitores në frymën e fundit

Fitore dramatike e Tiranës, Skënderbeu në tapet



Jeton Selimi

Ka përfunduar me një fitore të madhe të Tiranës ndeshja në Korçë mes Skënderbeut dhe kryeqytetasve, që arrijnë të triumfojnë në shpëtimin e bardhekuqve pas gati 5 vitesh. Një fitore e ardhur në castet e fundit të sfidës, që e ngre moralin dhe adrenalinën e Tiranës në maksimum në prag të ndeshjes derbi ndaj Partizanit, çka u shfaq edhe në lotët e trajnerit Mema, që nuk i përmblodhi dot emocionet pas golit të fitores. Në Korçë do të nisë një lojë e shpejtë dhe e luftuar nga të dyja skuadrat, ndërsa të dyja ekipet shtynjë për të gjetur golin e avantazhit. Rrjeta e parë do të tundet në minutën e 27-të, me bardheblutë që kanë kaluar në avantazh. Ka qenë një aksion i rrjedhshëm nga e majta për kryeqytetasit me topin që përfundon të Ngo dhe e zhvendos te Kobina, i cili është i pamarkuar në shtyllën e dytë dhe mposht Dajsinanin. Goli i dytë radhazi ky për afrikamin pas atij kundër Luftëtarit. Gjithsesi Skënderbeu nuk



do të dorëzohet dhe do të rikthejë baraspeshën në limitet e pjesës së parë. Muzaka pason në zonë nga e djathta dhe Siboi i gjendur i pamarkuar në qendër

SULMUESI EGJIPTIAN

28 vite pa titull kampion, Salah: Po e ndjejmë presionin

Liverpuli i mungon titulli kampion që prej vitit të largët 1991, kur "Reds"-at triumfuan për herë të fundit në Premier Ligë. Që prej asaj dite të kuqtë nga "Anfield Road" i janë afruar disa herë, por kurrë nuk kanë mundur të kurorëzohen, ndërsa kanë vuajtur jo pak fuqizimin e klubeve të ndryshëm si Çelsi apo Mançester Siti. Këtë sezon Liverpuli është një nga kandidatët potencialë, ndërsa për shumë javë ka qenë në krye të klasifikimit, madje dhe duke u shkëputur, por distancat janë ngushtuar sërisht dhe Salah e ka një shpjegim për këtë situatë. "Është normale të ketë presion, e kam thënë edhe më parë. Nëse synon të fitosh titullin, duhet të punosh shumë dhe të mësohesh me presionin. Tani është ndryshe, sepse jemi afër fundit të kampionatit, por 3 pikët kanë të njëjtin vlerë si në fillimin e sezonit. Për mua është një ëndërr të fitoj titullin me Liverpul", - tha sulmuesi egjiptian.

SUPERLIGA	
<b>TE PREMTEN</b>	
Skënderbeu - Tirana	1-2
<b>TE SHTUNEN</b>	
Luftëtari - Teuta	14:00
Partizani - Flamurtari	17:00
<b>TE DIELEN</b>	
Kastrioti - Laçi	14:00
Kukësi - Kamza	14:00

të zonës, godet saktë duke mposhtur portierin Abibi dhe duke iu përgjigjur golit të Kobinas, çka bën që skuadrat të shkojnë në pushim me rezultatit e barabartë 1-1. Pjesa e dytë do të nisë me Skënderbeun më të orientuar drejt sulmit. Korçarët do të shfaqen disa herë në zonën e Abibit, por çdo gjë do të mbetet te kërcënimin. Ndërsa në portën e Dajsi-

nanit gjërat do të ndryshojnë. Tirana do t'i afrohet golit me Grecën në minutën e 89-të, por gardani bardhekuq bën mrekullinë. Me topin e rifituar nga Tirana, bardheblutë këmbëngulin sërisht në krahun e djathtë dhe pak çaste më pas, Ngo nuk do të gabojë në diagonalen e tij, duke qarë peshë tifozërinë kryeqytetase që kishte udhëtuar në Korçë. Emocionet shpërthejnë në stolin e Tiranës, me trajnerin Mema që nuk i përmblodhi dot lotët e gëzimit për këtë fitore të madhe, e cila e çon skuadrën e tij me moralin në qiell në prag të derbit ndaj Partizanit të premtën e ardhshme. Tirana do të ngjitet në kuotën e 28 pikëve, ndërsa Skënderbeu do të mbetet në kuotën e 33 pikëve, teksa në 9 sfidat e fundit ka humbur plot 8 përballje.

TRAJNERI I SKËNDERBEUT

Shehi i pikëlluar: Vetëm ne pësojmë gola të tillë!

Orges Shehi ka qenë mjaft i zhgënjyer për humbjen e pësuar në castet e fundit të takimit kundër Tiranës, ndërsa e shpreh haptazi mërzinë e tij për golin e dytë të shënuar nga Majkëll Ngo, që sipas teknikut durrsak, ishte tërësisht i evitueshëm. "Zhgënjimi është prezent. Të humbësh një ndeshje të tillë, të vjen keq. Kundërshtari na erdhi i herë e gjysmë në portë. I marrim golat shumë lehtë. Sidomos

ky goli i dytë. Është për të ardhur keq. Ne kemi punuar. Goli i dytë është vendosje gabim plus edhe shumë të lehtë në driblim. Mospasja e mbrojtësve të mirëfilltë ndikon. Ushtruan presion, luajtëm gjatë gjithë kohës në fushën e Tiranës. Kemi pasur mungesa, dalja e Abazit na çorientoi fare. Mbetëm me 1 mbrojtës. Na prishi punë, u prishën ekuilibrat. S'kishim mundësi të tjera, ata lojtarë kishim. Sam-

boun s'mund ta hidhja në fushë, sepse bëheshin 5 të huaj. Është një situata jo e mirë, mbas gjithë këtyre ndeshje nuk marrim rezultate. Përgjegjësia e parë e marr unë. Duhet të rrimë të gjithë mbrapa dhe të luajmë kundërsulm. Prodhim shumë lojë dhe më pas pësojmë. E gjithë puna që bëjmë na shkon dëm. Duhet të zgjedhim lojtarë që të mbrojnë dhe mos e kenë mendjen te sulm".

ZHVILLIME TE BARDHEZINJTË

Alegri nuk bind më, Zidane ose Guardiola për stolin e Juventusit


Shembja morale dhe ekonomike që ka pësuar Juventusi pas disfatës ndaj Atletiko Madridit, ka bërë që drejtuesit bardhezinjtë mendojnë për opsione të tjera për të ringritur klubin. Humbja 2-0 në "Vanda Metropolitan" ka tronditur thellësisht pozitën e Alegrit, me trajnerin që është në skadencë kontrate në fund të këtij edicioni, madje flitet se në rast eliminimi (që është shumë i mundshëm), trajneri nga Livorno të sh-



karkohet. Në ikën Alegri, emrat e mundshëm për ta zëvendësuar janë dy. Zinedin Zidane dhe Pep Guardiola. Zidane është aktualisht i pa impenjuar dhe mund ta merrte klubin që në këtë moment, por do të kërkonte investime në merkato me Marcelon dhe Izkon në krye të listës. Më i vështirë duket Guardiola, por nëse ajo që shkruajnë mediat angleze për një divorc të katalanasit me Mançester Sitin është e vërtetë atëherë Juventusi mund të hidhet në sulm për trajnerin ndoshta më të mirin në qarkullim.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Janë luftarake me kung fu.
- Eshhtë me helm ajo e agjentëve.
- Skuadra merengue.
- Fillojnë tatëpjetën.
- Ed aktor.
- Një pjesë... orkestrale.
- Një iranian i dikurshëm.
- Janë tek në kanape.
- I bën kush ha bukë.
- Fundi i një fundi.
- Fillojnë aksionin.
- Janë zeshkanë.
- Shumë zëra në këngë.
- Gjysmë turneu.
- Eshhtë grykësi.
- Rastisin në krye.
- Sikur ke thënë çdonjerin.
- Janë vite.
- Angot e Lecocq.
- Ende është ndryshe.

- Kush bën... ve në lojë.
- Janë grimca me bërthama.
- Turner këngëtare.
- Të parat në bllok.
- Difong për leader.
- Dhe Hajria në një balet.
- Neill aktor.
- Ross këngëtare.
- Mund të jetë paraboliqe.

**VERTIKAL**

- Janë kundërmuese.
- Vreri pa kufij.
- Kush nuk ka... nuk di të sillet.
- Artikull spanjoll.
- Eshhtë krimb për grep.
- Mbyllin një krah.
- Edouard piktor.
- Fillojnë profesionin.
- Turke pa kufij.
- Ishte Gjermania e Honecker
- Janë më shumë se dëshira.
- Janë ujërat në lixha.
- Bëhet me kandar.
- I dëgjo vetëm Odiseu.
- Fillojnë hetimin.
- Një qendër.
- Eshhtë vjedhje.
- Makashi këngëtar.
- Me Alfa në makinë.
- Loriku të Sunderland.
- Një pjesë e momenteve.
- Gjysmë tatimi.
- Janë legjenda.
- Nget edhe ajo e mirë.
- Myslymi i paharruar i futbollit.
- Ki Moon i OKB.
- Flemig që krijoi James Bond.
- Fillojnë hapur
- Mbyllin komentin.
- Fillojnë safte.
- Fillojnë masat.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Eshhtë kombëtare me minoritetin.
- Janë godinat e banimit.
- Van Nistelrooy bomber.
- Eshhtë e e pas Krishtit.
- Një fjalë para kohe.
- Organizma Tregare Lokale.
- Rripi pa zë.
- Filoko aktor
- Volumi i shkurtër.
- Eshhtë diletant.
- Kufizojnë pozicionin.
- Eshhtë X ajo e sulmit.
- Ishin shoqëruetit e Panit.
- Kufizojnë katete.
- Janë çupa.
- Bartok kompozitor.
- Tri të parat në atletikë.
- Tekat pa kufij.
- Një pemë.
- Skuadër greke.

**VERTIKAL**


- Janë shkaktarë shერი.
- Kanë bërë vepra.
- Eshhtë shtëpi me frëngji.
- Filimi i ideologjisë.
- Inicialet e Einstein.
- Janë gazetat si RD.
- Lodh në kufij.
- Ishte lumi i harresës.
- Eshhtë për medaljen e parë.
- Një fjalë që tregon ritmin.
- Kolegj i famshëm anglez.
- Janë pesë të tillë olimpikë.
- Janë zengjine.
- Kishte 100 porta.
- Një pjesë e masakrës.
- Mbarojnë fare.
- Janë toka edhe sportive.
- Stoker që shkroi Dracula.
- Eshhtë byrek.
- Hapur pa kufij.
- Pal latinishte.
- Rrage pa re
- Film i famshëm me Brad Pitt dhe Kevin Spacey.
- Qyteti i përjetshëm.
- Një jepet për hartim.
- Jessica aktore.
- Cruise aktor
- Janë në kupë.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRÇJQJËT E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

P E T E R K P A M O R E  
A M E N K B A N O R E T  
R A M I T A E D E M A  
P I E A N A T E M A T  
R T E I E P A T I T  
E K O N O M I K E R E S T  
K E N E T A T R O B E R T  
E M R E H R O M B I  
S I N G E R I N A T I N  
S A J I D I T E K T I M O  
S H I T N E N E M I R  
D A M A R T A K T E T E

**FJALËKRYQI (2)**

S P O T P B A A L E A S  
A S O P E R E T A T A S  
U O P E R A T I D O R A  
L I P L I P O T I M I A  
M O N O T O N I I R O N  
L I Z T O R T I L O N  
A T I A N T E U E N I S  
D I T A I I L U M I S  
A M A N E T A L G A T F  
E I R I S A R E N E  
S T O L T K U R A T A R  
P M A K E T E L E H T E



**SUDOK**

7									1
6			4	7				8	
4		6	8					3	9
			7	3	6				
5									5
									3
	1		9						
		7			9				
3		8	1				7	4	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

5	4	1	6	8	7	3	9	2	
3	9	7	5	1	2	4	6	8	
8	2	6	9	3	4	7	1	5	
1	5	8	7	4	9	2	3	6	
4	6	2	8	5	3	9	7	1	
7	3	9	1	2	6	5	8	4	
9	1	5	2	7	8	6	4	3	
2	7	4	3	6	1	8	5	9	
6	8	3	4	9	5	1	2	7	

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

2	14	2	7	4	5	9	7	7	19	3	6	
4	2	3	3	2	5	9	7	6	8	4	14	
9	3	5	6	A		17	1	8	9	6	2	
7	10		18	9	7	4	9	5	6	4	7	
6		5	4	3	5	2	12	9	4	2	20	
	5	2	4	2	1	3	9	4	2	4	6	
3	1	5	6	6	2	9	7	2	4		12	8
2	8	2		15	6	4	4	4	7	1	15	
16	9	16		2	14	6		9	1	8	2	
2	4	2	5		1	14	6		12	6	3	
4	1		2	6		17	6	4	6	14		
6	3	7	9	18	6	4		15	6	7	2	4

D R I T A R E T B O T E  
O R A P F B E L A T  
B I K O L O N E L B I  
I F I T O R E T T E K  
K O M E N T E T E L E  
H A R E M E R E R A T  
T A M T A M A S R A  
S A E D S T I  
D T E K S T M I T E T  
E H R R I K I L O N I  
M I R I A M K R E R E T  
I T A P I N A T I O

**Thënie të mënçura**

- Ndonjëherë sakrifikon gjithçka për dikë. Dhe ai të sakrifikon ty për asgjë.
- Në varfëri ka shumë mangësi gjërash. Sidoqoftë, në lakminë mungon gjithçka.
- Nëse duhej të mbyllnim të gjithë idiotët në një dhomë të madhe, nuk do të kishte njeri që të mbyllte derën.
- Të gjitha rrugët janë të njëjta nëse nuk e di se ku shkon.
- Të gjitha gjërat janë të vështira para se të bëhen të lehta.
- Kurrë mos lejo që dikush të jetë prioriteti yt, ndërsa ti për atë je një nga zgjidhjet alternative.

